

MATERIAL MËSIMOR

Në mbështetje të mësimdhënësve për Kualifikimin Profesional

Shërbime bankare

Niveli IV i KSHK-së

Ky material mësimor i referohet:

- **Lëndës profesionale**: “Bankat dhe sistemi financiar”, kl. 12 (L-17-253-25)

Përgatiti:

Anila Nanaj
Albjona Selimi
Ermira Mani
Fabiola Gykshi
Florijs Bega

Tiranë, 2025

Tema 1: Bankat dhe roli i tyre

1.1 Kuptimi mbi bankat. Llojet e bankave.

Banka është një institucion financiar që merret me mbledhjen e depozitave nga individë/biznese, si dhe me dhënien e kredive për ata që kanë nevojë për fonde. Ajo vepron si ndërmjetëse midis atyre që kanë tepriçë parash (kursimtarëve) dhe atyre që kanë mungesë (huamarrësve), duke ndihmuar në qarkullimin dhe përdorimin efikas të parasë në ekonomi.

Në rolin e saj si ndërmjetës financiar, një bankë pranon depozita dhe jep kredi. Ajo nxjerr një fitim nga diferenca midis kostove (përfshirë pagesat e interesit) të tërheqjes, shërbimit të depozitave dhe të ardhurave që merr përmes interesit të ngarkuar huamarrësve ose të fituara përmes letrave me vlerë. Shumë banka ofrojnë shërbime të lidhura me menaxhimin financiar dhe produkte në lidhje me fondet e ndërsjella dhe kartat e kreditit.

Llojet kryesore të bankave në botën moderne industriale janë bankat tregtare, të cilat zakonisht janë firma të sektorit privat të orientuara drejt fitimit, dhe bankat qendrore, të cilat janë institucione të sektorit publik. Bankat tregtare pranojnë depozita nga publiku i gjerë dhe japin lloje të ndryshme kredish (duke përfshirë kredi komerciale, konsumatore dhe të pasurive të paluajtshme) për individë dhe biznese dhe, në disa raste, për qeveri. Bankat qendrore, në të kundërt, merren kryesisht me qeveritë e tyre kombëtare sponsorizuese, me bankat komerciale dhe me njëra-tjetrën. Përveç pranimit të depozitave nga dhe dhënies së kredisë për këta klientë, bankat qendrore lëshojnë gjithashtu monedhë letrë dhe janë përgjegjëse për rregullimin e bankave komerciale dhe stoqeve kombëtare monetare.

1.2 Historiku i krijimit të bankave

Zanafilla e bankave lidhet me qytetërimet e lashta, si Mesopotamia, ku tempujt dhe pallatet mbretërore shërbenin si vende të sigurta për ruajtjen e mallrave me vlerë, kryesisht drithëra e ar. Këto institucione primitive ofronin edhe kredi dhe lejonin transferimin e pronësisë përmes faturave me shkrim, duke u konsideruar si format më të hershme të bankizimit.

Në kohët mesjetare, u shfaqën “protobankat” që merreshin me këmbimin e monedhave dhe furnizimin me valutë të huaj. Me zhvillimin e tregtisë, sidomos në Evropë, lindën bankat tregtare, të cilat ndihmonin tregtarët të kryenin pagesa në distancë përmes kambialeve, duke shmangur transportimin e metaleve të çmuara. Këto banka fitonin nga shkëmbimi valutor dhe normat e interesit të fshehura në kursin e këmbimit. Në shekujt XVI–XVII, bankat u zhvilluan më tej dhe u ndanë në dy tipe kryesore:

1. Bankat e këmbimit, si Banka e Amsterdemit dhe Banka e Hamburgut, që lehtësonin tregtinë ndërkombëtare dhe ruanin stabilitetin e valutave.
2. Bankat e depozitave, si Banka e Anglisë, Banka e Venedikut dhe Banka e Francës, që merrnin depozita, jepnin kredi dhe financuan tregtinë dhe industrinë.

Në këtë periudhë, edhe argjendarët dhe shkruesit e parave në Londër nisën të ofronin shërbime bankare, duke ruajtur para për klientët dhe duke dhënë hua me interes.

Në thelb, zhvillimi historik i bankave kaloi nga ruajtja e mallrave dhe monedhave të ndërmjetësimit financiar, krijimi i parasë, dhe lehtësimi i tregtisë ndërkombëtare, duke u bërë një shtyllë thelbësore e sistemit ekonomik modern.

1.3 Rëndësia e sistemit bankar në zhvillimin ekonomik të një vendi

Sistemi bankar ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të një vendi, pasi mundëson qarkullimin e parasë dhe financimin e ekonomisë. Ai mbledh kursimet e individëve dhe i kthen ato në kredi për biznese dhe projekte investimi, duke nxitur prodhimin dhe punësimin. Gjithashtu, sistemi bankar ndihmon në ruajtjen e stabilitetit financiar, kontrollin e inflacionit dhe krijimin e besimit në tregun financiar. Përmes tij realizohen pagesat, investimet dhe politikat monetare që mbështesin rritjen e qëndrueshme ekonomike.

Banka është krijuar në bazë të një sistemi që ka për qëllim të merret me depozitat monetare, ruajtjen e kursimeve të klientëve dhe huadhënien për qëllime financiare. Me kalimin e kohës dhe zhvillimin e shpejtë të teknologjisë po shfaqen gjithnjë e më shumë mundësi të reja veprimi ku mund të përmendim:

- Veprimet nëpërmjet internet-it.
- Përdorimi i kartave të kreditit.
- Bankomatet për tërheqjen e parave.

Zhvillimi dhe efektiviteti i këtyre tre elementeve është i rëndësishëm në ecurinë e një bankë në kohët e sotme. Zhvillimi ekonomik i një vendi është i lidhur ngushtë me zhvillimin e sektorit financiar e veçanërisht sektorit bankar.

1.4 Funksionet kryesore të bankave

Bankat luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë e çdo vendi, duke kryer funksione thelbësore që sigurojnë qarkullimin e parasë dhe zhvillimin financiar. Funksionet kryesore të bankave janë:

Ndërmjetësimi financiar - Bankat mbledhin kursimet e individëve dhe bizneseve (depozita) dhe i japin si kredi atyre që kanë nevojë për financim. Kjo ndihmon në qarkullimin e parasë dhe nxit investimet.

Krijimi i parasë - Përmes procesit të dhënies së kredive, bankat krijojnë para të reja në ekonomi, duke zgjeruar ofertën monetare. Ky proces kontrollohet nga bankat qendrore, që përcaktojnë normat e interesit dhe politikat monetare.

Transmetimi i politikës monetare - Bankat janë kanali kryesor përmes të cilit vendimet e bankës qendrore (p.sh. ulja e normës së interesit) ndikojnë në tregjet financiare, konsum dhe investime.

Menaxhimi i rrezikut financiar - Bankat ofrojnë shërbime që ndihmojnë klientët të mbrohen nga rreziqe (si sigurimi i kursit të këmbimit, normave të interesit, etj.).

Ruajtja dhe transferimi i pasurisë - Bankat sigurojnë ruajtje të sigurt të depozitave, llogarive dhe pasurive të klientëve. Ato mundësojnë edhe transferime brenda dhe jashtë vendit.

Lehtësimi i pagesave - Bankat operojnë sistemet e pagesave (me karta, transfertë, internet banking) që mundësojnë funksionimin e tregtisë dhe ekonomisë globale.

1.5 Roli i bankave në sistemin financiar botëror

Bankat luajnë rol kryesor në sistemin financiar botëror, sepse lehtësojnë tregtinë ndërkombëtare, qarkullimin e kapitalit dhe investimet, duke siguruar stabilitet dhe bashkëpunim ekonomik mes vendeve të shprehur si më poshtë:

Motor i rritjes ekonomike. Bankat financojnë bizneset, industrinë dhe konsumatorët, duke gjeneruar punësim dhe prodhim. Zhvillimi i sektorit bankar lidhet ngushtë me rritjen e PBB-së në çdo vend.

Sigurimi i stabilitetit financiar. Bankat përbëjnë bazën e sistemit financiar, prandaj qëndrueshmëria e tyre është thelbësore për të shmangur kriza. Rregullimi dhe mbikëqyrja e tyre nga autoritetet financiare është një element kyç.

Integrimi global financiar. Bankat ndërkombëtare lehtësojnë investimet, tregtinë dhe qarkullimin e kapitalit ndërmjet vendeve, duke lidhur ekonominë botërore.

Zhvillimi teknologjik dhe digjitalizimi. Bankat janë në qendër të inovacionit financiar përmes shërbimeve online, pagesave digjitale dhe fintech-ve.

Përkrahja e zhvillimit të qëndrueshëm. Në dekadat e fundit, bankat kanë marrë rol aktiv në financimin e projekteve “të gjelbra” dhe të qëndrueshme, duke ndihmuar tranzicionin drejt një ekonomie më miqësore me mjedisin.

Tema 2: Sistemi financiar dhe struktura e tij

2.1 Kuptimi dhe funksionet e sistemit financiar

Sistemi financiar është një rrjet i organizuar institucionesh, tregjesh, instrumentesh dhe rregullash që lehtësojnë qarkullimin e e parave, kredive dhe investimeve në ekonomi. Ai krijon lidhjen midis individëve apo bizneseve që kanë tepricë financiare që ndryshe quhen kursimtarë dhe atyre që kanë mungesë ose investitorët apo huamarrësit. Në thelb, sistemi financiar është “motori i gjakut ekonomik” të një vendi. Ai furnizon bizneset me kapital, individët me kredi, dhe shtetin me mjete për zhvillim.

Funksioni kryesor i sistemit financiar është **ndërmjetësimi financiar**, që do të thotë transformimi i kursimeve në investime. Ky proces nxit zhvillimin ekonomik, sepse fondet e papërdorura nuk qëndrojnë pasive, por investohen në aktivitete prodhuese. Sistemi financiar gjithashtu ndihmon në:

- Menaxhimin e rrezikut, përmes sigurimeve dhe instrumenteve financiare që mbrojnë nga humbjet e papritura.
- Krijimin e likuiditetit, duke i bërë të mundshme pagesat dhe transferimet e fondeve në kohë reale.
- Përcaktimin e çmimeve të kapitalit, përmes tregjeve financiare që formojnë çmimin e aksioneve, obligacioneve e valutave.
- Mbështetjen e politikës monetare, përmes bashkëpunimit me bankën qendrore.

Funksione të tjera të sistemit financiar janë thelbësore për zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin financiar. Këto funksione kanë të bëjnë me:

➤ Mobilizimin dhe kanalizimin e kursimeve

Sistemi financiar siguron mekanizmat për të mbledhur kursimet nga individët, familjet dhe bizneset. Këto fonde kanalizohen drejt investimeve produktive si bizneset, projektet industriale, infrastruktura etj. Pa këtë funksion, kapitali do të mbetej i shpërndarë dhe i pashfrytëzuar.

➤ Shpërndarjen efiçiente të kapitaleve

Institucionet financiare i drejtojnë fondet drejt atyre që kanë nevojë për financim (biznese, qeveri, individë). Ato lejojnë që kapitali të shkojë te projektet më fitimprurëse dhe më të qëndrueshme, duke ndihmuar në rritjen e produktivitetit dhe zhvillimit ekonomik.

➤ **Transformimin e maturiteteve**

Bankat dhe institucionet financiare konvertojnë depozitat afatshkurtra të kursimtarëve në kredi afatgjata për bizneset dhe familjet. Ky proces u mundëson huamarrësve të marrin fonde me afat të gjatë, ndërsa kursimtarëve të kenë mundësi të tërheqin paratë kur të duan.

➤ **Menaxhimin dhe diversifikimin e rrezikut**

Sistemi financiar ofron mjete për të mbrojtur pasurinë dhe investimet nga rreziqet ekonomike, ku përfshihen sigurimet, derivatet, fondet e investimit dhe diversifikimin e portofolit, ul rrezikun individual dhe stabilizon ekonominë.

➤ **Lehtësimin e pagesave dhe transaksioneve**

Sistemi financiar ofron sisteme të sigurta dhe efikase për kryerjen e pagesave nëpërmjet kartave bankare, online banking, transferimeve elektronike etj. Pa këtë funksion, ekonomia nuk mund të funksiononte në mënyrë moderne.

➤ **Transparencën dhe marrjen e vendimeve financiare**

Sistemi financiar siguron informacion të besueshëm për çmimet, normat e interesit, kursin e këmbimit dhe tregjet. Kjo transparencë i ndihmon bizneset dhe individët të marrin vendime të informuara.

➤ **Nxitjen e stabilitetit financiar**

Institucionet si bankat qendrore dhe autoritetet rregullatore garantojnë stabilitetin e sistemit financiar. Ato monitorojnë rreziqet sistemike, ruajnë likuiditetin, ndërhyjnë në kohë krize dhe sigurojnë funksionim normal të tregjeve.

➤ **Mbështetjen e zhvillimit ekonomik**

Duke financuar investimet, teknologjinë, inovacionin dhe konsumin, sistemi financiar nxit rritjen ekonomike afatgjatë dhe siguron një klimë të qëndrueshme për bizneset dhe investitorët.

2.2 Përbërësit kryesorë të sistemit financiar

Përbërësit e sistemit financiar përfshijnë institucionet, tregjet, instrumentet, rregullat dhe infrastrukturën, të cilat bashkëpunojnë për të siguruar qarkullimin efikas të fondeve dhe funksionimin e qëndrueshëm të ekonomisë.

➤ **Institucionet financiare**

Institucionet financiare janë zemra e sistemit financiar. Në këtë grup përfshihen bankat, institucionet mikrofinanciare, shoqëritë e sigurimeve, fondet e pensioneve, kompanitë e leasingut, si dhe shumë organizata të tjera që ofrojnë shërbime financiare. Roli i tyre kryesor është të pranojnë depozita, të japin kredi, të sigurojnë individët dhe bizneset kundër rreziqeve, si dhe të administrojnë kursimet dhe investimet afatgjata. Këto institucione krijojnë besim dhe siguri në treg sepse operojnë nën rregulla të rrepta dhe nën mbikëqyrjen e autoriteteve shtetërore.

➤ **Tregjet financiare**

Tregjet financiare janë vendi ku takohen blerësit dhe shitësit e instrumenteve financiare. Ato përfshijnë tregjet monetare (ku qarkullojnë instrumente afatshkurtra), tregjet kapitale (ku tregtohen aksione dhe obligacione), tregjet primare dhe sekondare, si dhe tregjet e derivateve. Në këto tregje, çmimet formohen në bazë të kërkesës dhe ofertës, duke i dhënë ekonomisë sinjale të rëndësishme për investimet dhe riskun. Tregjet financiare mundësojnë qarkullim të shpejtë të kapitalit dhe ofrojnë fushë për rritjen ekonomike.

➤ **Instrumentet financiare**

Instrumentet financiare janë mjetet që përdoren për të kryer transaksione dhe për të transferuar para ose risk. Për shembull, kartat bankare, obligacionet, aksionet, çeqet, kreditë, depozitat dhe derivatet janë të gjitha instrumente që lehtësojnë lëvizjen e fondeve. Secili instrument ka

karakteristikat e veta. Disa sigurojnë të ardhura të garantuara, disa ofrojnë mundësi fitimi më të lartë, por me risk më të madh. Këto instrumente e bëjnë sistemin financiar fleksibël dhe të përshtatshëm për nevoja të ndryshme.

➤ **Infrastruktura financiare**

Infrastruktura financiare përfshin të gjitha sistemet teknologjike dhe rregullat që mundësojnë funksionimin e sigurt dhe efikas të transaksioneve. Këtu përfshihen sistemet e pagesave, platformat elektronike të këmbimit valutor, rrjetet bankare online, si dhe korniza ligjore që i rregullon këto procese. Pa një infrastrukturë të qëndrueshme si, sistemi i pagesave me kartë, transfertat bankare, ose sistemet kombëtare të kleringut ekonomia do të ishte e ngadaltë, e pasigurt dhe kaotike.

➤ **Autoritetet rregullatore dhe mbikëqyrëse**

Një pjesë shumë e rëndësishme e sistemit financiar janë autoritetet që e mbikëqyrin atë. Ato janë banka qendrore, autoriteti i mbikëqyrjes financiare, ministria e financave dhe agjenci të tjera shtetërore. Detyra e tyre është të garantojnë stabilitetin financiar, të mbrojnë konsumatorët, të sigurojnë transparencë në tregje dhe të parandalojnë shkeljet ose abuzimet. Pa rregullim, sistemi financiar do të ishte i pasigurt dhe i cënueshëm ndaj krizave.

➤ **Pjesëmarrësit e tregut**

Këtu përfshihen individët, bizneset, investitorët, ndërmjetësit financiarë, ndërmarrjet e mëdha dhe të vogla, si dhe institucionet publike. Të gjithë këta kontribuojnë në funksionimin e sistemit financiar duke kursyer, investuar, marrë kredi, apo duke kryer transaksione të ndryshme.

2.3 Roli i bankave në sistemin financiar

Bankat zënë një pozicion qendror në sistemin financiar, sepse ato veprojnë si ndërmjetëse kryesore mes individëve, bizneseve dhe institucioneve që kanë fonde të lira dhe atyre që kanë nevojë për financim. Roli bazë i bankave është të veprojnë si ura lidhëse midis kursimtarëve dhe huamarrësve. Individët dhe bizneset që kanë para të tepërta i depozitojnë në bankë, ndërsa banka i përdor këto fonde për t'i dhënë kredi atyre që kanë nevojë. Ky proces quhet **ndërmjetësim financiar**, dhe është thelbësor për qarkullimin e kapitalit në ekonomi. Falë bankave, paratë nuk qëndrojnë të bllokuara, por shndërrohen në investime, konsum, biznese të reja dhe rritje ekonomike. Për të kuptuar rëndësinë e tyre, duhet të analizojmë rolin që ato kryejnë:

➤ **Ndërmjetësimi financiar**

Bankat mbledhin depozita nga individët dhe bizneset që kanë kursime dhe i japin këto fonde si kredi për ata që kanë nevojë për investime. Në këtë mënyrë, ato:

- lehtësojnë qarkullimin e fondeve në ekonomi;
- rrisin efikasitetin e përdorimit të kapitalit;
- reduktojnë kostot e transaksioneve dhe kërkimit për huamarrës dhe huadhënës.

➤ **Mbajtja dhe administrimi i depozitave**

Bankat sigurojnë një vend të sigurt që quhet depozitë. **Depozita** është shuma e parave që një individ, biznes apo institucion vendos në një bankë me qëllim ruajtjen e sigurt të tyre dhe përdorimin e shërbimeve bankare ku individët dhe bizneset mund të ruajnë paratë e tyre. Kjo krijon likuiditet dhe besim në ekonomi. Depozitat mund të jenë:

- depozita rrjedhëse (llogari pagese);
- depozita kursimi;
- depozita afatgjata.

➤ **Lëshimi i kredive**

Kredia është një nga funksionet kryesore që nxit rritjen ekonomike. Përmes kredidhënies, bankat financojnë:

- investimet e bizneseve;
- blerjen e pasurive të paluajtshme;
- konsumin e familjeve;
- projektet e zhvillimit ekonomik.

➤ **Kryerja e pagesave dhe shërbimeve të transfertës**

Efikasiteti në pagesa ul rreziqet dhe përshpejton aktivitetin ekonomik. Bankat menaxhojnë sistemet e pagesave të vendit duke mundësuar:

- transfertat brenda bankës dhe ndërbankare;
- pagesa elektronike;
- shërbime me kartë debiti/krediti;
- pagesa ndërkombëtare.

➤ **Administrimi i riskut**

Bankat luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e risqeve financiare. Ato përdorin teknika të specializuara për të vlerësuar klientët dhe për të reduktuar humbjet e mundshme përfshirë:

- riskun e kreditit;
- riskun e likuiditetit;
- riskun e tregut.

➤ **Mbështetja e stabilitetit financiar**

Vetë funksionimi i bankave monitorohet nga autoritetet mbikëqyrëse për të siguruar stabilitet të plotë. Duke qenë institucione mijëra klientësh, bankat kontribuojnë në:

- mbrojtjen e sistemit nga krizat financiare;
- ruajtjen e besimit të publikut;
- funksionimin e rregullt të sistemit të pagesave.

➤ **Produkte dhe shërbime financiare**

Bankat ofrojnë një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh, të cilat ndihmojnë individët dhe bizneset të planifikojnë dhe menaxhojnë financat e tyre, të tilla si:

- këshillim financiar;
- llogari kursimi dhe investimi;
- garanci bankare;
- shërbime valutore dhe këmbimi;
- depozitë në kasaforta të sigurta.

2.4 Institucionet e tjera financiare dhe funksionet e tyre

Përveç bankave, sistemi financiar përfshin një grup institucionesh jobankare që ofrojnë shërbime të specializuara në fushat e sigurimeve, investimeve, pensione, leasingut dhe mikrofinancës. Këto institucione janë të domosdoshme për funksionimin modern të ekonomisë, sepse plotësojnë rolet që bankat nuk i kryejnë drejtpërdrejt dhe u ofrojnë individëve e bizneseve akses më të gjerë në financim dhe menaxhim rreziku. Përmes tyre, tregu financiar bëhet më konkurrues, më fleksibël dhe më i aftë të përgjigjet ndaj nevojave të ndryshme të konsumatorëve.

✓ **Shoqëritë e sigurimeve**

Shoqëritë e sigurimeve janë institucione që ofrojnë mbrojtje financiare kundër rreziqeve të ndryshme, si aksidente, dëmtime të pronës, sëmundje, humbje në biznes ose rreziqe natyrore. Funksionet kryesore të tyre janë:

- Menaxhimi i rrezikut që ka të bëjë me sigurimin e klientëve nga humbjet e mundshme.
- Grumbullimi i fondeve që ka të bëjë me mbledhjen e primeve të sigurimit dhe investimin në tregjet financiare.
- Siguria e konsumatorit që ka të bëjë me garantimin e stabilitetit financiar në raste të humbjeve të mëdha.
- Kontribut në ekonomi që ka të bëjë me investimin e fondeve të mbledhura në projektet afatgjata.

✓ **Shoqëritë e mikrofinancës**

Institucionet mikrofinanciare u ofrojnë kredi individëve ose bizneseve të vogla që shpesh nuk kanë mundësi të marrin financim nga bankat. Ato janë të rëndësishme sidomos në zonat rurale ose për grupet me të ardhura të ulëta. Funksionet e tyre janë:

- Dhënia e kredive të vogla për start-up ose aktivitete bujqësore.
- Mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe familjare.
- Rritje e përfshirjes financiare.

✓ **Shoqëritë e kursim-kreditit**

Këto janë institucione ku anëtarët depozitojnë fonde dhe mund të marrin kredi, zakonisht me kushte më të favorshme se bankat ku mbizotëron parimi i bashkëpunimit dhe anëtarësisë. Funksionet kryesore të tyre janë:

- Marrja e depozitave dhe dhënia e kredive: veçanërisht për qëllime familjare ose të vogla biznesi.
- Mbështetje komunitare: operojnë shpesh në zona të vogla dhe njohin mirë anëtarët e tyre.
- Kosto më të ulëta financiare.

✓ **Shoqëritë e leasingut**

Leasingu është një formë financimi që u mundëson bizneseve dhe individëve të përdorin pajisje, automjete, makineri apo mjete të tjera pa pasur nevojë t'i blejnë menjëherë. Funksionet e shoqërive të leasingut janë:

- Financimi i aseteve për përdorim afatmesëm ose afatgjatë.
- Ulje e ngarkesës financiare të bizneseve.
- Lehtësi likuiditeti, pasi pagesat kryhen në këste.
- Përditësim i teknologjisë pa investime të menjëhershme.

✓ **Fondet e pensione**

Fondet e pensione mbledhin kontribute nga individët gjatë viteve të punës dhe i investojnë ato për t'i siguruar të ardhura në moshën e pensionit. Funksionet e këtyre fondeve janë:

- Grumbullimi i kursimeve afatgjata.
- Investimi i fondeve në tregjet financiare.
- Sigurimi i stabilitetit financiar në pleqëri.
- Kontribut në zhvillimin e tregjeve të kapitalit.

✓ **Fondet e investimeve**

Janë institucione që mbledhin fonde nga shumë investitorë dhe i investojnë ato në aksione, obligacione, pasuri të paluajtshme ose instrumente të tjera financiare. Funksionet kryesore të tyre janë:

- Diversifikimi i rrezikut: ndarja e investimit në shumë instrumente.
- Menaxhimi profesional i portofolit.
- Mundësia që investitorët e vegjël të marrin pjesë në tregjet financiare.
- Likuiditet i shpejtë në blerjen dhe shitjen e kuotave.

✓ **Bursat dhe platformat e këmbimit**

Edhe pse nuk janë institucione klasike si bankat, bursat e letrave me vlerë dhe platformat elektronike konsiderohen pjesë kyçe e infrastrukturës financiare. Funkcionet kryesore të tyre janë:

- Lehtësojnë tregtimin e aksioneve dhe obligacioneve.
- Vendosin çmime të drejta përmes kërkesës dhe ofertës.
- Rrisin transparencën dhe besueshmërinë e tregut.

✓ **Agjencitë e vlerësimit të kreditit**

Këto institucione vlerësojnë aftësinë paguese të individëve, bizneseve ose institucioneve shtetërore. Funksione të rëndësishme të këtyre institucioneve janë:

- Përcaktojnë riskun e kreditimit.
- Ndhmojnë bankat dhe investitorët të marrin vendime të sakta.
- Përmirësojnë disiplinën financiare.

Këto institucione kanë rëndësi të veçantë sepse rrisin konkurrencën në tregun financiar, përmirësojnë aksesin në shërbime financiare dhe ndihmojnë në zhvillimin ekonomik rajonal.

2.5 Infrastruktura financiare

Infrastruktura financiare përbën bazën teknike, institucionale dhe ligjore që mundëson funksionimin e sigurt dhe efikas të sistemit financiar. Pa këtë infrastrukturë, institucionet financiare nuk do të ishin në gjendje të kryenin pagesa, të shkëmbejnë informacion, të menaxhonin rrezikun ose të zbatonin transaksione në mënyrën e duhur. Ajo përfshin sistemet e pagesave, platformat elektronike, rregulloret ligjore, databazat e kredive dhe tregjet formale ku shkëmbehen instrumente financiare.

Një element qendror i infrastrukturës financiare janë sistemet e pagesave. Këto sisteme lejojnë kryerjen e transaksioneve ndërmjet individëve, bizneseve dhe bankave, duke garantuar që pagesat të jenë të sigurta, të shpejta dhe të gjurmueshme. Sistemet moderne të pagesave përfshijnë transfertat elektronike, karta bankare, pagesa online dhe sistemet ndërbankare, të cilat ndihmojnë në zvogëlimin e kostove dhe rritjen e efikasitetit ekonomik.

Po aq të rëndësishme janë platformat e tregimit dhe bursat, të cilat krijojnë një mjedis të rregulluar ku aksionet, obligacionet dhe instrumentet e tjera financiare mund të blihen dhe shiten me transparencë. Ato garantojnë vendosjen e çmimeve të drejta përmes ndërveprimit të kërkesës dhe ofertës dhe sigurojnë rregulla të unifikuara për të gjithë pjesëmarrësit në treg.

Kuadri ligjor dhe rregullator është një tjetër shtyllë e infrastrukturës financiare. Ligjet dhe udhëzimet përcaktojnë mënyrën se si institucionet financiare duhet të operojnë, si të mbrojnë konsumatorët, si të raportojnë informacionin dhe si të sigurojnë stabilitetin e sistemit. Pa një kuadër të qartë ligjor, tregjet financiare do të ishin të pasigurta dhe joefikase.

Një pjesë thelbësore e kësaj infrastrukture janë edhe regjistrat e kredive dhe databazat e informacionit financiar. Këto sisteme përmbajnë të dhëna mbi historinë kreditore të individëve dhe bizneseve, duke ndihmuar bankat dhe institucionet e tjera të vlerësojnë më mirë rrezikun dhe të marrin vendime të sakta për dhënien e kredive. Transparenca që ofrojnë këto databaza ul abuzimet dhe përmirëson disiplinën financiare.

2.6 Ndërveprimi i elementëve të sistemit financiar dhe mbikëqyrja e tij

Sistemi financiar funksionon si një rrjet i ndërlidhur institucionesh, tregjesh dhe instrumentesh. Çdo element ka rolin e vet, por askush nuk vepron i izoluar. Bankat japin kredi për bizneset, ndërsa kompanitë e sigurimeve mbrojnë ato nga rreziqet. Fondet e pensioneve dhe investimeve ofrojnë

kapital afatgjatë, kurse tregjet financiare krijojnë mundësi për rritje dhe diversifikim. Ky bashkëveprim:

- Nxiti **rritjen ekonomike**, pasi lejon investime më të mëdha dhe krijon vende të reja pune.
- Përmirëson **stabilitetin financiar**, përmes mbikëqyrjes dhe shpërndarjes së rrezikut.
- Forcon **besimin e publikut** ndaj sistemit financiar, një element thelbësor për çdo ekonomi moderne.

Në rastet kur ndonjë hallkë dështon (p.sh. krizat bankare, inflacioni i lartë ose pasiguria në tregje), ndikimi përhapet shpejt në të gjithë ekonominë. Kjo është arsyeja pse roli i rregullimit dhe mbikëqyrjes është jetik për funksionimin e shëndetshëm të sistemit financiar.

Sistemi financiar funksionon si një rrjet i ndërlidhur institucioneve, tregjesh dhe instrumentesh që bashkëpunojnë për të mundësuar qarkullimin e parasë dhe kapitalit në ekonomi. Asnjë element nuk vepron i izoluar: bankat, tregjet financiare, institucionet jobankare dhe rregullatorët ndërveprojnë vazhdimisht për të mbështetur veprimtarinë ekonomike dhe për të garantuar stabilitetin financiar.

Në qendër të këtij ndërveprimi qëndrojnë bankat, të cilat pranojnë depozita, japin kredi dhe ofrojnë pagesa për individë dhe biznese. Ato lidhen drejtpërdrejt me tregjet financiare, ku blejnë ose shesin instrumente si obligacione ose bono thesari për të menaxhuar likuiditetin dhe riskun. Nga ana tjetër, bankat bashkëpunojnë me institucionet e tjera financiare, si kompanitë e sigurimeve apo fondet e pensioneve, duke i ndihmuar ato të investojnë fondet e mbledhura ose të menaxhojnë rreziqet. Tregjet financiare shërbejnë si vendi ku përcaktohen çmimet e instrumenteve financiare dhe ku aktorët ekonomikë gjejnë financim ose mundësi investimi. Bankat dhe institucionet jobankare përdorin këto tregje për të siguruar fonde, për të investuar tepricat financiare ose për të diversifikuar portofolin e tyre. Ky shkëmbim i vazhdueshëm informacionesh dhe kapitalesh e bën sistemin financiar të funksionojë në mënyrë harmonike.

Brenda këtij sistemi, një rol të madh luajnë instrumentet financiare, të cilat veprojnë si ura lidhëse mes institucioneve dhe tregjeve. Çdo produkt financiar si kreditë, aksionet, obligacionet, apo derivativët përdoret nga aktorë të ndryshëm, duke krijuar një rrjet dinamik që siguron qarkullim të kapitalit në të gjithë ekonominë. Pikërisht për shkak se ky sistem është i ndërlidhur dhe ndonjëherë i ndjeshëm ndaj rreziqeve, është e domosdoshme mbikëqyrja financiare. Mbikëqyrja kryhet nga institucione shtetërore të specializuara, të cilat sigurojnë që bankat dhe institucionet e tjera financiare të veprojnë sipas ligjit dhe të ruajnë stabilitetin financiar. Qëllimi i mbikëqyrjes nuk është ndërhyrja në veprimtarinë e përditshme, por krijimi i një mjedisi të sigurt ku rreziqet identifikohen me kohë dhe ku klientët mbrohen nga praktikatat e padrejta.

Mbikëqyrja financiare përfshin kontrollin e kapitalit të bankave, monitorimin e tregjeve financiare, licencimin e institucioneve dhe zbatimin e rregullave që parandalojnë pastrimin e parave apo mashtrimet. Ajo siguron që institucionet të kenë mjaftueshëm rezerva për të përballuar humbjet, që informacionet të jenë të sakta dhe transparente, dhe që veprimet e tyre të mos rrezikojnë stabilitetin e sistemit në tërësi. Ndërveprimi i elementëve të sistemit financiar dhe mbikëqyrja e tyre formojnë një strukturë të qëndrueshme, ku secili aktor ka rolin e vet, por të gjitha pjesët varen nga njëra-tjetra. Falë kësaj ndërthurjeje, ekonomia mund të zhvillohet në mënyrë të sigurt, investimet të realizohen me efikasitet dhe publiku të ketë besim në sistemin financiar.

Tema 3: Rregullat dhe normat ndërkombëtare për bankat

3.1 Kuptimi i rregullave dhe standardeve ndërkombëtare bankare

Në një botë ku bankat operojnë jo vetëm brenda kufijve të një shteti, por edhe në tregje të huaja, është thelbësore që të ekzistojnë rregulla dhe standarde ndërkombëtare. Ato sigurojnë funksionim të qëndrueshëm, të sigurt dhe transparent të sistemit bankar global. Rregullat ndërkombëtare bankare janë një grup parimesh, udhëzimesh dhe standardesh që përcaktojnë mënyrën e menaxhimit të kapitalit, likuiditetit, rreziqeve dhe transparencës financiare. Qëllimi i tyre kryesor është të:

- Sigurojnë stabilitetin e sistemit financiar global.
- Mbrojnë depozituesit dhe investitorët.
- Parandalojnë krizat bankare ndërkombëtare.
- Nxisin konkurrencë të ndershme dhe praktika të përgjegjshme në sektorin financiar.

Rregullat ndërkombëtare janë krijuar për të shmangur situatat ku dështimi i një banke të madhe mund të shkaktojë pasoja zinxhir në mbarë ekonominë botërore. Një bankë që vepron në një vend mund të ketë partneritete, investime apo filiale në vende të tjera. Nëse secili shtet do të kishte vetëm rregullat e veta, pa një kuadër të përbashkët ndërkombëtar, do të krijoheshin boshllëqe ligjore dhe rreziqe të mëdha financiare. Prandaj, standardet ndërkombëtare sigurojnë që:

- Bankat të kenë të njëjtin nivel mbrojtjeje dhe përgjegjësie, pavarësisht vendit ku veprojnë.
- Mbikëqyrësit financiarë të bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacion.
- Rregullat kombëtare të jenë në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Kjo do të thotë se një bankë që operon në Shqipëri, për shembull, duhet të respektojë të njëjtat parime të qëndrueshmërisë dhe transparencës si një bankë në Gjermani apo Francë. Standardet dhe normat ndërkombëtare bankare mund të ndahen në disa kategori kryesore:

- Standardet rregullatore, që përcaktojnë se sa kapital minimal duhet të mbajë një bankë për t'u mbrojtur nga humbjet.
- Standardet e raportimit dhe transparencës, që detyrojnë bankat të raportojnë informacion financiar të saktë dhe të krahësueshëm.
- Standardet për menaxhimin e rrezikut, që rregullojnë mënyrën si bankat duhet të identifikojnë dhe kontrollojnë rreziqet e tyre (kreditimi, tregu, operacionet, likuiditeti).
- Standardet etike dhe të qeverisjes korporative, që kërkojnë ndershmëri, përgjegjësi dhe integritet në menaxhimin bankar.

Këto standarde nuk janë thjesht rregulla teknike, por themeli i **besimit financiar**, pa të cilin sistemi bankar nuk mund të funksionojë në mënyrë efektive. Rregullat ndërkombëtare nuk janë krijuar nga një shtet i vetëm, por nga organizata dhe forume të përbashkëta ndërkombëtare, si:

- **Banka për Rregullime Ndërkombëtare (BIS)** është institucioni më i vjetër financiar ndërkombëtar, që bashkon bankat qendrore të shumë vendeve.
- **Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrje Bankare** harton standardet për kapitalin dhe rreziqet bankare.
- **Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)** dhe **Banka Botërore** ofron asistencë teknike dhe vlerësojnë stabilitetin financiar global.
- **Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB)** harton rregullat për raportimin financiar (IFRS).

Këto institucione punojnë së bashku për të krijuar një kuadër të unifikuar që mund të zbatohet në të gjitha vendet. Respektimi i këtyre normave siguron:

- Mbrojtje për klientët – depozitat dhe investimet janë më të sigurta.
- Besueshmëri për bankën – rritet imazhi dhe reputacioni ndërkombëtar.
- Qëndrueshmëri për sistemin financiar – parandalohen krizat dhe humbjet e mëdha.
- Integrim në ekonominë globale – vendet që respektojnë këto standarde kanë më shumë mundësi për investime të huaja.

3.2 Komiteti i Bazelit dhe roli i tij

Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare (Basel Committee on Banking Supervision – BCBS) është organi më i rëndësishëm ndërkombëtar që merret me vendosjen e standardeve për rregullimin dhe mbikëqyrjen e bankave në nivel global. Ai nuk është një institucion që jep ligje të detyrueshme, por prodhon standarde, parime dhe udhëzime që vendet e ndryshme i adoptojnë në kuadrin e tyre ligjor për të garantuar një sistem bankar të sigurt dhe të qëndrueshëm.

Themelimi dhe qëllimi i Komitetit të Bazelit

Komiteti është krijuar në vitin 1974 nga guvernatorët e bankave qendrore të vendeve të G-10, pas disa krizave bankare që treguan se mungesa e bashkëpunimit ndërkombëtar mund të rrezikonte mbarë sistemin financiar. Qëllimi kryesor i tij është të sigurojë që bankat të kenë nivele të mjaftueshme kapitali, likuiditeti dhe menaxhimi të rrezikut, pavarësisht vendit ku operojnë.

Funksionimi i Komitetit të Bazelit

Komiteti nuk ka fuqi ekzekutive, por rekomandimet e tij zbatohen pothuajse në të gjithë botën. Ai funksionon përmes:

- **Mbledhjeve të rregullta** të ekspertëve të bankave qendrore dhe autoriteteve mbikëqyrëse.
- **Punës së grupeve teknike** që analizojnë zhvillimet e tregjeve financiare.
- **Publikimit të standardeve ndërkombëtare**, të cilat njihen si marrëveshjet Basel I, Basel II dhe Basel III.

Shqipëria, ashtu si vendet e tjera të rajonit, bazon kuadrin e saj rregullator te standardet e Bazelit. Banka e Shqipërisë ka përafëruar:

- kërkesat për kapital minimal;
- rregullat për ekspozimet ndaj rrezikut;
- raportet e likuiditetit;
- kërkesat për raportim dhe transparencë.

Kjo siguron që bankat shqiptare të jenë në linjë me praktikat bashkëkohore evropiane dhe ndërkombëtare.

3.3 Marrëveshjet Basel I, Basel II dhe Basel III

Komiteti i Bazelit ka zhvilluar një seri marrëveshjesh ndërkombëtare që kanë për qëllim stabilizimin e sistemit bankar global dhe sigurimin që bankat të operojnë me kapital të mjaftueshëm dhe menaxhim të mirë të rreziqeve. Këto marrëveshje njihen si **Basel I, Basel II dhe Basel III** dhe secila ka sjellë ndryshime të rëndësishme në mënyrën e rregullimit bankar. Le të shohim secilën prej tyre:

1. Basel I (1988)

Basel I krijoi një kuadër të unifikuar për stabilitetin e bankave dhe siguroi një nivel minimal mbrojtjeje ndaj falimentimeve, pra ai pati si qëllim kryesor vendosjen e kapitalit minimal që bankat duhet të mbajnë për të mbuluar rreziqet e tyre dhe konkretisht:

- Bankat duhet të mbajnë **të paktën 8% kapital** në raport me aktivet e rrezikuara.

- Aktivitetet e bankave kategorizohen sipas nivelit të rrezikut (kredi ndaj qeverive, bizneseve, individëve, etj.).
- Basel I u fokusua kryesisht te **kapitali rregullator** dhe krijoi bazën e parë për një standard global të menaxhimit të rrezikut.

2. Basel II (2004)

Basel II siguroi që bankat të jenë më të përgjegjshme, të rrezikuara më pak dhe të raportojnë në mënyrë transparente, duke ulur mundësinë e krizave financiare. Ai pati si qëllim kryesor përmirësimin dhe zgjerimin e rregullave të Basel I, duke u fokusuar jo vetëm te kapitali, por edhe te mbikëqyrja dhe transparenca. Basel II bazohet në tri shtylla kryesore:

1. **Kërkesat minimale të kapitalit:**
 - o Rregullime më të detajuara për kapitalin, duke marrë parasysh llojet e ndryshme të rrezikut: kredit, tregu dhe operacional.
2. **Mbikëqyrja efektive:**
 - o Autoritetet rregullatore duhet të monitorojnë bankat për të siguruar që ato zbatojnë politikat e menaxhimit të rrezikut.
3. **Disiplina e tregut:**
 - o Bankat duhet të jenë transparente dhe të publikojnë informacione të mjaftueshme për veprimtarinë e tyre, në mënyrë që tregu të ndikojë në sjelljen e tyre.

3. Basel III (2010–2017)

Basel III rrit sigurinë e sistemit bankar dhe u siguroi që bankat të jenë më të forta dhe më rezistente ndaj krizave financiare globale. Ai pati si qëllim kryesor përforcimin e bankave pas krizës financiare globale të vitit 2008 dhe rritjen e rezistencës së sistemit financiar.

- **Kapital më i lartë dhe më cilësor**, bankat duhet të kenë kapital më të qëndrueshëm për të mbrojtur kundër humbjeve të papritura.
- **Kërkesa për likuiditet**, banka duhet të ketë fonde të mjaftueshme për të përballuar krizë likuiditeti afatshkurtër dhe afatgjatë.
- **Kufizimi i levës financiare**, kontroll mbi huazimet dhe ekspozimet për të shmangur mbingarkesën me borxhe.
- **Masa për bankat sistemike**, bankat “tepër të mëdha për të dështuar” duhet të kenë mbrojtje shtesë për stabilitetin global.

3.4 Standardet IFRS në sektorin bankar

Bankat nuk operojnë vetëm në fushën e dhënies së kredive dhe pranimi të depozitave. Një pjesë shumë e rëndësishme e veprimtarisë së tyre është raportimi financiar, i cili tregon në mënyrë të qartë dhe të saktë gjendjen ekonomike të bankës. Për të siguruar që raportimi të jetë i besueshëm, i krahasueshëm dhe i kuptueshëm në të gjithë botën, bankat ndjekin **Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS)**.

➤ Çfarë janë standardet IFRS?

Këto standarde janë udhëzime që përcaktojnë mënyrën e shënimit, vlerësimit dhe prezantimit të informacionit financiar. IFRS janë rregulla ndërkombëtare për kontabilitetin dhe raportimin financiar, të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB). Qëllimi i tyre është që çdo raport financiar të jetë i saktë dhe transparent, në mënyrë që investitorët, bankat qendrore dhe publiku të marrin informacion të besueshëm për gjendjen financiare të bankë

➤ Pse bankat duhet të zbatojnë IFRS?

Standardet IFRS janë të domosdoshme për disa arsye:

- **Transparencë** pasi bankat tregojnë qartë pasuritë, detyrimet dhe kapitalin që mbajnë.
- **Krahasueshmëri** pasi investitorët dhe autoritetet mund të krahasojnë performancën e bankave në vende të ndryshme.
- **Besueshmëri** pasi raportet e sakta i japin publikut dhe depozituesve siguri për sigurinë e fondeve të tyre.
- **Mbështetje për vendimmarrje** pasi bankat dhe autoritetet mbikëqyrëse marrin vendime më të mira bazuar në të dhëna të sakta.

➤ **Si ndikojnë IFRS në veprimtarinë bankare?**

Bankat përdorin IFRS për të raportuar mbi:

- Kreditë dhe borxhet që do të thotë sa kredi janë dhënë dhe cilat mund të jenë të papaguara.
- Investimet dhe portofolin e aktivëve që do të thotë si janë investuar fondet dhe sa rrezik përmbajnë.
- Kapitalin dhe rezervat që do të thotë sa kapital kanë bankat për të përballuar humbjet e mundshme.
- Fitimet dhe humbjet që do të thotë si ka funksionuar banka gjatë periudhës së raportuar.

Kjo siguron që çdo bankë të ketë një qasje të unifikuar dhe transparente, duke reduktuar rrezikun e gabimeve ose mashtrimeve.

➤ **Ku qëndron rëndësia për sistemin financiar global?**

Në një botë ku bankat janë të ndërlidhura, informacioni i saktë financiar është thelbësor për stabilitetin e sistemit. IFRS ndihmon:

- Investitorët të marrin vendime të informuara.
- Autoritetet mbikëqyrëse të monitorojnë sistemin.
- Tregjet ndërkombëtare të funksionojnë me besim.
- Krizat financiare të parandalohen ose të menaxhohen më mirë.

Zbatimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar (IFRS) bën që bankat të jenë më të qarta, të besueshme dhe të përgjegjshme. Kjo rrit besimin e publikut, siguron stabilitetin e sistemit bankar dhe lehtëson bashkëpunimin ndërkombëtar në sektorin financiar.

3.5 Rregullat për menaxhimin e rrezikut dhe mbikëqyrjen bankare

Bankat nuk operojnë vetëm me pasuri dhe depozita. Ato gjithashtu përballen me rreziqe të shumta që mund të ndikojnë mbi stabilitetin e tyre dhe mbi sistemin financiar në tërësi. Për këtë arsye, ekzistojnë rregulla ndërkombëtare për menaxhimin e rrezikut dhe mbikëqyrjen bankare, të cilat sigurojnë që bankat të veprojnë me kujdes dhe përgjegjësi. Menaxhimi i rrezikut është procesi i identifikimit, matjes dhe kontrollit të rreziqeve që bankat mund të përballen gjatë veprimtarisë së tyre. Rreziqet kryesore përfshijnë:

- **Rreziku i kreditit** – që ka të bëjë me humbjet nga kredia që nuk kthehet.
- **Rreziku i tregut** – që ka të bëjë me ndryshimet e papritura të çmimeve, normave të interesit ose valutës.
- **Rreziku operacional** – që ka të bëjë me humbjet nga gabime të brendshme, mashtrime apo defekte në sistemet bankare.
- **Rreziku i likuiditetit** – që ka të bëjë me mungesat e fondeve të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e bankës.

Rregullat ndërkombëtare kërkojnë që bankat të kenë sisteme të forta dhe të strukturuar për të menaxhuar këto rreziqe.

Mbikëqyrja bankare është procesi ku autoritetet financiare dhe bankat qendrore kontrollojnë dhe vlerësojnë funksionimin e bankave, duke siguruar që ato të respektojnë standardet ndërkombëtare. Kjo përfshin:

- Vlerësimin e kapitalit dhe likuiditetit të bankës.
- Kontrollin e raportimeve financiare dhe të dhënave për rrezikun.
- Sigurimin që bankat të kenë procedura të sakta për menaxhimin e rrezikut.
- Parandalimin e aktiviteteve që mund të dëmtojnë stabilitetin financiar.

Pa menaxhim të mirë të rrezikut dhe mbikëqyrje efektive:

- Bankat mund të përballen me humbje të mëdha dhe falimentime.
- Stabiliteti i sistemit financiar global mund të shkaktojë kriza.
- Publiku dhe investitorët mund të humbasin besimin në bankat dhe tregjet financiare.

Rregullat ndërkombëtare sigurojnë që bankat të veprojnë me përgjegjësi, transparencë dhe siguri, duke parandaluar krizën financiare dhe duke mbrojtur depozituesit dhe investitorët.

3.6 Zbatimi i rregullave ndërkombëtare në sistemin bankar shqiptar

Edhe pse marrëveshjet dhe standardet ndërkombëtare për bankat janë krijuar për të gjithë botën, çdo vend i përshtat ato sipas kushtetutës dhe ligjeve kombëtare. Shqipëria, si pjesë e ekonomisë globale dhe me lidhje financiare ndërkombëtare, ka marrë masa për të zbatuar standardet ndërkombëtare dhe për të mbajtur sistemin e saj bankar të qëndrueshëm dhe të besueshëm.

Integrimi i standardeve ndërkombëtare në ligjet shqiptare

Sistemi bankar shqiptar është i rregulluar nga **Banka e Shqipërisë**, e cila vepron si autoritet mbikëqyrës dhe rregullator i bankave. Kjo bankë ka përshtatur standardet Bazel, IFRS dhe rregulla të tjera ndërkombëtare në:

- Kërkesat për kapitalin që duhet të mbajnë bankat.
- Rregullat për menaxhimin e rrezikut, duke përfshirë kreditimin dhe likuiditetin.
- Raportimin financiar dhe transparencën, për të siguruar që informacioni për publikun dhe investitorët të jetë i saktë dhe i kuptueshëm.

Kjo i lejon bankat shqiptare të operojnë me siguri dhe të jenë pjesë e tregjeve ndërkombëtare.

Mbikëqyrja dhe kontrolli nga Banka e Shqipërisë

Banka e Shqipërisë monitoron vazhdimisht veprimtarinë e bankave dhe siguron që ato të zbatojnë rregullat ndërkombëtare. Disa nga aktivitetet kryesore të mbikëqyrjes përfshijnë:

- Kontrollin e kapitalit dhe likuiditetit, për të shmangur falimentimet.
- Vlerësimin e rrezikut të kreditit dhe tregut, për të parandaluar humbjet.
- Kontrollin e raportimeve financiare, për të siguruar që informacioni i publikuar të jetë i saktë.
- Mbështetjen dhe udhëzimin e bankave, për t'i ndihmuar ato të zbatojnë praktikën më të mira ndërkombëtare.

Kjo mbikëqyrje siguron që publiku, investitorët dhe bizneset të kenë besim te bankat shqiptare.

Përfitimet për sistemin bankar shqiptar

Zbatimi i rregullave ndërkombëtare sjell shumë përfitime për Shqipërinë dhe bankat e saj:

- Stabilitet financiar – bankat janë më të sigurta dhe më të qëndrueshme.
- Besim i publikut – depozituesit e dinë që fondet e tyre janë të mbrojtura.
- Integrim në ekonominë globale – bankat mund të bashkëpunojnë me institucione ndërkombëtare dhe të marrin pjesë në tregjet financiare.

- Parandalimi i krizave – rregullat reduktojnë rreziqet dhe pengojnë përhapjen e problemeve financiare.

Sistemi bankar shqiptar ka bërë hapa të rëndësishëm për të zbatuar standardet dhe rregullat ndërkombëtare, duke e bërë më të fortë dhe më të besueshëm. Mbikëqyrja e Bankës së Shqipërisë dhe respektimi i rregullave ndërkombëtare sigurojnë që bankat të veprojnë me përgjegjësi, duke mbrojtur depozituesit, investitorët dhe ekonominë e vendit, ndërkohë që Shqipëria mbetet e lidhur me tregjet financiare globale.

Tema 4: Sistemi bankar në Shqipëri

4.1 Historiku i zhvillimit të sistemit bankar në Shqipëri

Zhvillimi i sistemit bankar në Shqipëri ka kaluar në disa etapa të rëndësishme, të lidhura ngushtë me ndryshimet politike dhe ekonomike të vendit. Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 1912, Shqipëria nuk kishte ende një sistem bankar të organizuar. Veprimet financiare kryheshin nga tregtarë, huadhënës privatë dhe disa filiale bankash të huaja që vepronin në qytetet kryesore. Në vitin 1925 u krijua **Banka Kombëtare e Shqipërisë**, me kapital të përbashkët italo-shqiptar, e cila shërbeu si banka qendrore dhe tregtare njëkohësisht. Kjo periudhë shënoi hapat e parë të institucionalizimit të sistemit bankar, megjithëse ndikimi i huaj ishte i madh.

Pas Luftës së Dytë Botërore dhe vendosjes së sistemit socialist, u nacionalizuan të gjitha institucionet financiare. U krijua **Banka e Shtetit Shqiptar**, që vepronte si e vetmja bankë në vend, duke përbushur njëkohësisht funksionet e bankës qendrore, tregtare dhe zhvillimore. Gjatë kësaj periudhe sistemi bankar ishte plotësisht i centralizuar, në përputhje me modelin e ekonomisë së planifikuar. Kreditimi i ekonomisë bëhej sipas planeve shtetërore dhe nuk ekzistonte konkurrencë apo shërbime bankare për qytetarët në kuptimin modern.

Pas rënies së sistemit komunist dhe kalimit në ekonominë e tregut, nisi një reformim i thellë i sistemit bankar. Në vitin 1992 u krijua **Banka e Shqipërisë**, e cila mori funksionet e bankës qendrore dhe u përcaktua si institucioni që zbaton politikën monetare, ruan stabilitetin e çmimeve dhe mbikëqyr sistemin bankar. Njëkohësisht, u hapën banka të reja shtetërore dhe private, si Banka Kombëtare Tregtare, Banka e Kursimeve, Banka e Kreditit etj. Gjatë kësaj kohe, sistemi bankar u përball me vështirësi, përfshirë mungesë përvoje, infrastrukturë të dobët dhe krizën e piramidave financiare të vitit 1997, e cila tronditi besimin e publikut.

Në fillim të viteve 2000, sistemi bankar shqiptar nisi të konsolidohej. U privatizuan bankat shtetërore, si Banka e Kursimeve (2004), e blerë nga grupi Raiffeisen. U rrit prania e bankave të huaja si Intesa Sanpaolo, Alpha Bank, ProCredit Bank dhe Credins. U zhvilluan shërbimet elektronike, u përmirësua legjislacioni financiar dhe u forcua mbikëqyrja nga Banka e Shqipërisë. Sistemi bankar u bë më i qëndrueshëm dhe filloi të mbështesë më mirë sektorin privat dhe individët. Në dekadën e fundit, sistemi bankar shqiptar është karakterizuar nga digjitalizimi dhe rritja e konkurrencës. Bankat ofrojnë sot shërbime online, mobile banking dhe pagesa elektronike. Janë zbatuar rregulla të reja për menaxhimin e rrezikut, përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare (Bazel III) dhe për mbrojtjen e konsumatorëve financiarë. U ndërmorën gjithashtu hapa drejt integritimit me sistemet financiare të Bashkimit Europian.

Banka e Shqipërisë vazhdon të luajë një rol kyç në ruajtjen e stabilitetit financiar, mbikëqyrjen e institucioneve bankare dhe promovimin e inovacionit financiar. Sot sistemi bankar shqiptar përbëhet nga një numër i kufizuar bankash të qëndrueshme, me kapital të huaj dominues, që ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh moderne dhe kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.

4.2 Sistemi bankar në Shqipëri

“Është më mirë që njerëzit e vendit të mos e kuptojnë sistemin tonë bankar dhe monetar, sepse nëse do ta kuptonin, besoj se do të kishte një revolucion para mëngjesit të nesërm.”

- Henry Ford -

Sistemi bankar në Shqipëri është organizuar në dy nivele:

Në nivelin e parë është banka qendrore. Banka qendrore është një institucion kushtetues i cili, në një këndvështrim të gjerë, ushtron funksione “qeverisëse”. Banka e Shqipërisë është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë.

Në nivelin e dytë qëndrojnë bankat tregtare. Këto banka janë ndërmjetës të pastër financiarë, të ngritura në formën e shoqërive aksionere dhe që kanë si qëllim sigurimin e fitimit për pronarët e tyre.

Banka e Shqipërisë është banka qendrore, e cila me anë të selisë qendrore në Tiranë dhe disa degëve të saj në rrethe mbulon të gjithë vendin. Banka e Shqipërisë është autoriteti i vetëm përgjegjës për liçensimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemit bankar në Shqipëri. Ky autoritet është gjithashtu përgjegjës për liçensimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e subjekteve financiare jobanka, shoqërive të kursim – kreditit e unioneve të tyre dhe zyra të këmbimit valutor që ushtrojnë veprimtari bankare ose veprimtari të tjera financiare në Republikën e Shqipërisë.

Bankat tregtare janë banka të nivelit të dytë dhe janë të vetmet institucione financiare që ushtrojnë njëkohësisht veprimtarinë e pranimit të depozitave monetare dhe veprimtarinë e kredidhënies. Përveç këtyre veprimtarive, bankat ofrojnë shërbime pagesash dhe ushtrojnë veprimtari të tjera financiare, ku, ndër këto mund të përmendim veprimet nëpërmjet internetit, përdorimin i kartave të debitit dhe kreditit, ATM për tërheqjen/depozitim të parave, arkëtime dhe pagesa për llogari të të tretëve, këshillime financiare etj.

Aktualisht në Shqipëri operojnë 17 banka të nivelit të dytë, pjesa më e madhe e të cilave janë me kapital të huaj. Disa nga bankat tregtare që operojnë në Shqipëri janë: Banka Amerikane e Investimeve sh.a., Banka Credins sh.a., Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a., banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a., Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a., Banka Kombëtare Tregtare sh.a., Banka OTP Albania sh.a., Banka Procredit sh.a., Banka Raiffeisen sh.a., Banka Tirana sh.a., Banka Union sh.a., etj.

4.3 Funksionet e Bankës së Shqipërisë

Banka e Shqipërisë është **banka qendrore** e vendit dhe ka një rol të rëndësishëm në stabilitetin ekonomik e financiar. Në cilësinë e autoritetit monetar e mbikëqyrës të vendit, Banka e Shqipërisë, për të arritur objektivin kryesor të saj, kryen edhe një sërë funksionesh mbështetëse të cilat janë:

- **Emetimi i parasë.** Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive për emetimin e kartëmonedhës dhe të monedhës kombëtare me kurs ligjor dhe furnizimin e rregullt të ekonomisë me para brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
- **Politika monetare.** Banka e Shqipërisë harton, miraton dhe zbaton politikën monetare të vendit, për realizimin e objektivave të së cilës ajo përdor instrumentet e duhura monetare.
- **Stabiliteti financiar.** Banka e Shqipërisë ka përgjegjësinë të garantojë që sistemi bankar në veçanti dhe ai financiar në përgjithësi, të jetë i qëndrueshëm dhe eficient.

- **Këmbimi valutor.** Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për hartimin, miratimin dhe zbatimin e regjimit të këmbimit valutor, si dhe të politikës së kursit të këmbimit në Republikën e Shqipërisë.
- **Mbikëqyrja.** Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive të licencojë ose revokojë licencën për ushtrimin e veprimtarisë bankare, si dhe rregullon e mbikëqyr bankat tregtare që zhvillojnë aktivitet në Shqipëri.
- **Rezerva valutore.** Banka e Shqipërisë mban dhe administron rezervat valutore të Republikës së Shqipërisë.
- **Agjent fiskal dhe këshilltar i qeverisë.** Një tjetër funksion i Bankës së Shqipërisë është që të veprojë në cilësinë e bankierit, të këshilltarit dhe të agjentit fiskal për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë.
- **Sistemet e pagesave.** Një nga detyrat kryesore të Bankës së Shqipërisë është të nxisë dhe të garantojë funksionimin normal të sistemit kombëtar të pagesave.

4.4 Organizimi i Bankës Qëndrore në Shqipëri

Këshilli Mbikëqyrës është organi më i lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Ai është përgjegjës për hartimin e politikës monetare dhe për miratimin e udhëzimeve për zbatimin e saj. Gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës vendos mbi politikat e administrimit në përgjithësi, si dhe përcakton mënyrat ose procedurat për realizimin e veprimtarisë operative të Bankës së Shqipërisë, duke siguruar kështu administrimin e drejtë të institucionit dhe përgjegjshmërinë kundrejt publikut për veprimet, angazhimin dhe rezultatet e saj.

Në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", Guvernatori vepron si Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Bankës së Shqipërisë, i ngarkuar për mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të saj dhe si Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Ai përgjigjet përpara Këshillit Mbikëqyrës për zbatimin e vendimeve të miratuara, duke përfshirë zbatimin e politikës monetare, të kreditit dhe të këmbimeve valutore, si dhe për drejtimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen mbi administrimin dhe operacionet e Bankës së Shqipërisë. Në veçanti, i njihen kompetencat për të kryer veprimet e kërkuara ose të gjykuara si të pranueshme prej tij për administrimin ose për operacionet e Bankës së Shqipërisë.

Këshilli Mbikëqyrës është organi më i lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Ai është përgjegjës për hartimin e politikës monetare dhe për miratimin e udhëzimeve për zbatimin e saj. Gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës vendos mbi politikat e administrimit në përgjithësi, si dhe përcakton mënyrat ose procedurat për realizimin e veprimtarisë operative të Bankës së Shqipërisë, duke siguruar kështu administrimin e drejtë të institucionit dhe përgjegjshmërinë kundrejt publikut për veprimet, angazhimin dhe rezultatet e saj. Këshilli Mbikëqyrës kryesohet nga Guvernatori dhe përbëhet nga nëntë anëtarë, si më poshtë:

- Guvernatori - Kryetar
- Zëvendësguvernatori i Parë - Zëvendëskryetare
- Zëvendësguvernatori i Dytë; dhe
- Gjashtë anëtarë të tjerë.

Të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës zgjidhen dhe emërohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me një mandat 7-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, mbështetur në propozimet e bëra si më poshtë:

- Pesë anëtarë propozohen nga Kuvendi.
- Tre anëtarë propozohen nga Këshilli i Ministrave.

- Një anëtar propozohet nga Këshilli Mbikëqyrës.

4.5 Legjislacioni për sistemin bankar në Shqipëri

Zbatimi i legjislacionit bankar në Shqipëri është i rëndësishëm për funksionimin e qëndrueshëm, të sigurt dhe transparent të sistemit financiar. Kuadri ligjor dhe nënligjor përcakton rregullat që garantojnë stabilitetin ekonomik, mbrojtjen e interesave të qytetarëve dhe zhvillimin e një tregu bankar modern në përputhje me standardet ndërkombëtare. Sistemi bankar shqiptar mbështetet në disa ligje themelore:

- *Ligji Nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”* – Ky ligj përcakton statusin, funksionet dhe kompetencat e Bankës së Shqipërisë si bankë qendrore, përgjegjëse për zbatimin e politikës monetare, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe mbikëqyrjen e sistemit bankar.
- *Ligji Nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”* – Ky ligj rregullon liçencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e bankave tregtare dhe degëve të bankave të huaja, duke përcaktuar standarde për menaxhimin financiar dhe mbrojtjen e depozituesve.
- *Ligji Nr. 131/2016 për disa ndryshime në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në republikën e shqipërisë", të ndryshuar* - Synon përmirësimin e kuadrit ligjor të veprimtarisë bankare në Shqipëri, duke përafruar legjislacionin kombëtar me standardet e Bashkimit Europian. Ai forcon mbikëqyrjen, menaxhimin e rrezikut dhe transparencën në funksionimin e bankave.
- *Ligji Nr. 133/2013 “Për sistemin e pagesave” dhe Ligji Nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesës”* - Garantojnë funksionimin efikas të sistemeve të pagesave dhe zhvillimin e tregut të pagesave elektronike, në përputhje me udhëzimet e Bashkimit Europian.

Aktet nënligjore:

Në mbështetje të këtyre ligjeve, Banka e Shqipërisë miraton aktet kryesore nënligjore për zbatim nga bankat/degët e bankave të huaja, si dhe subjektet financiare jobankare të liçencuara nga Banka e Shqipërisë. Këto akte publikohen në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, si dhe/ose në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe përfshijnë edhe rregullore, udhëzime dhe vendime që adresojnë fusha si: mbikëqyrja, pagesat, paraja, politika monetare, tregjet, ndërhyrja e jashtëzakonshme, arkiva.

4.6 Rëndësia e zbatimit të legjislacionit bankar

Zbatimi i legjislacionit në fuqi është një garanci për integritetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit bankar shqiptar. Ai mundëson funksionimin korrekt të tregut financiar, ruajtjen e besimit publik dhe përgatitjen e vendit për integrim të plotë në sistemin financiar europian. Aspektet kryesore që përshkruajnë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit bankar shprehen si më poshtë:

Siguron stabilitet financiar - Zbatimi i ligjeve lejon Bankën e Shqipërisë të ruajë ekuilibrin monetar, të kontrollojë inflacionin dhe të parandalojë krizat bankare.

Mbron interesat e depozituesve dhe klientëve - Ligjet dhe rregulloret përcaktojnë standarde të detyrueshme për transparencë, trajtim të drejtë dhe ruajtje të depozitave të qytetarëve.

Rrit besimin në sistemin bankar - Zbatimi i saktë i legjislacionit përforcon besimin e publikut dhe investitorëve në bankat shqiptare.

Përputhshmëri me standardet e Bashkimit Europian - Kuadri ligjor bankar është harmonizuar me direktivat e BE-së për mbikëqyrjen bankare, transparencën financiare dhe shërbimet e pagesave.
Promovon zhvillimin ekonomik - Një sistem bankar i mirë rregulluar siguron financime të qëndrueshme për bizneset dhe individët, duke nxitur investimet dhe punësimin.
Ndihmon në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit - Ligjet dhe rregulloret vendosin detyrime të qarta për raportim dhe kontroll të transaksioneve financiare.

Tema 5: Tregjet financiare dhe bankat

5.1 Kuptimi dhe funksionet e tregjeve financiare

Tregjet financiare janë vendet ku takohen ata që kanë fonde të tepërta (kursimtarët, investitorët) dhe ata që kanë nevojë për fonde (bizneset, qeveria, individët). Ato mundësojnë qarkullimin e kapitalit nga ofertuesit drejt përdoruesve të tij, duke lehtësuar zhvillimin ekonomik dhe rritjen e investimeve. Tregjet financiare janë një nga shtyllat kryesore të ekonomisë sepse:

- ✓ nxisin investimet duke kanalizuar kursimet drejt aktiviteteve prodhuese;
- ✓ rrisin efikasitetin ekonomik duke orientuar fondet aty ku japin më shumë përfitim;
- ✓ mbështesin zhvillimin e bizneseve dhe krijimin e vendeve të punës;
- ✓ ndihmojnë shtetin në sigurimin e fondeve për projektet publike;
- ✓ ofrojnë likuiditet, duke mundësuar kthimin e investimeve në para në çdo kohë.

Funksionet kryesore të tregjeve financiare

- ✓ **Transferimi i fondeve:** lidh ofertuesit dhe kërkuarësit e kapitalit.
- ✓ **Formimi i çmimeve:** përmes ofertës dhe kërkesës përcaktohet vlera reale e instrumenteve financiare.
- ✓ **Likuiditeti:** investitorët mund t'i shesin shpejt dhe lehtë asetet e tyre.
- ✓ **Reduktimi i rrezikut:** përmes diversifikimit dhe instrumenteve si sigurimet dhe derivatet.
- ✓ **Funksioni informues:** tregjet japin sinjale për gjendjen ekonomike dhe ndihmojnë në marrjen e politikave financiare dhe monetare.

5.2 Llojet e tregjeve financiare

Tregjet financiare nuk janë të gjitha të njëjta. Ato ndryshojnë sipas llojit të instrumenteve që tregtohen, kohëzgjatjes së tyre dhe funksionit që kryejnë në ekonomi. Në mënyrë të përgjithshme, tregjet financiare ndahen në dy grupe kryesore:

- Tregje të parave (monetare).
- Tregje të kapitaleve.

Përveç kësaj ndarjeje, ekziston edhe ndarja sipas momentit të emetimit të instrumenteve financiare, që i klasifikon në:

- Tregje primare dhe tregje sekondare.

Tregjet monetare : tregtohen instrumente financiare afatshkurtra, zakonisht me maturim deri në një vit. Këto tregje u shërbejnë nevojave të menjëhershme për likuiditet të bizneseve, qeverisë dhe institucioneve financiare. Qëllimi kryesor i tyre është siguri i likuiditetit dhe stabilitetit financiar në afat të shkurtër. Instrumentet kryesore të tregjeve monetare janë:

- Bonot e thesarit (të emetuara nga shteti).
- Depozitat afatshkurtra bankare.
- Letra tregtare.

- Marrëveshje për riblerje.

Tregjet e kapitaleve. Përfshijnë instrumente afatgjata me maturim mbi një vit. Këto u mundësojnë bizneseve dhe qeverive të sigurojnë fonde për investime afatgjata. Instrumentet kryesore:

- Aksionet – që përfaqësojnë pronësi në një kompani.
- Obligacionet – borxhe afatgjata që një kompani ose qeveri merr nga investitorët.

Tregu primar është vendi ku emetohet për herë të parë një instrument financiar. Në këtë treg ndodh transaksioni fillestar midis emetimit (p.sh., një kompani apo qeveri) dhe investitorëve. Ky treg i mundëson institucioneve të mbledhin fonde të reja për investime ose zhvillim.

Tregu sekondar është vendi ku tregtohen instrumentet ekzistuese, të cilat janë emetuar më parë në tregun primar, duke rritur likuiditetin dhe besimin e investitorëve. Në këtë treg, investitorët blejnë dhe shesin letra me vlerë ndërmjet tyre.

Tregje të tjera financiare:

- Tregu i këmbimit valutor – ku tregtohen monedha të ndryshme.
- Tregu i derivateve – ku tregtohen kontrata që bazohen në vlerën e instrumenteve të tjera (si aksione, indekse ose mallra).
- Tregu i sigurimeve dhe fondeve të investimit – që ndihmon shpërndarjen e rrezikut dhe grumbullimin e kapitalit.

Ndarja e tregjeve financiare ndihmon në kuptimin e rrjedhës së kapitalit në ekonomi. Tregjet monetare mbështesin operacionet afatshkurtra dhe stabilitetin, ndërsa tregjet e kapitaleve nxisin rritjen ekonomike afatgjatë. Nga ana tjetër, tregjet primare dhe sekondare sigurojnë që fondet të qarkullojnë vazhdimisht, të mbajnë gjallë sistemin financiar të një vendi.

5.3 Instrumentet financiare në tregjet financiare

Instrumentet financiare janë mjetet përmes të cilave realizohen transaksionet në tregjet financiare. Ato përfaqësojnë të drejta dhe detyrime financiare midis dy palëve, për shembull midis një investitori dhe një kompanie, ose midis një banke dhe shtetit. Në thelb, çdo instrument financiar është një kontratë që përcakton:

- sa para do të jepen ose merren;
- kur do të kthehen;
- dhe çfarë përfitimi (interesi apo fitimi) do të ketë investitori.

Instrumentet financiare ndahen kryesisht në dy grupe të mëdha:

1. Instrumente të tregut monetar – për afate të shkurtra (deri në 1 vit).
2. Instrumente të tregut të kapitalit – për afate të gjata (mbi 1 vit).

Llojet kryesore të instrumenteve

- ✓ **Aksionet:** përfaqësojnë pronësi në kompani dhe japin të drejtë për dividendë dhe fitim nga rritja e vlerës së aksionit.
- ✓ **Obligacionet:** përfaqësojnë borxh afatgjatë. Investitori merr interes periodik dhe kthimin e shumës kryesore në maturim.
- ✓ **Bonot e thesarit:** instrumente shumë të sigurta afatshkurtra të emetuara nga qeveria.
- ✓ **Certifikatat e depozitës:** lëshohen nga bankat për depozita me afat.
- ✓ **Letra tregtare:** borxh afatshkurtër i kompanive për nevoja të menjëhershme financiare.
- ✓ **Derivatet:** kontrata financiare që bazohen në vlerën e instrumenteve të tjera (aksione, indekse, monedha).

Instrumentet financiare janë mjeti kryesor për lëvizjen e kapitalit në ekonomi. Ato u mundësojnë individëve, bizneseve dhe qeverisë të sigurojnë ose investojnë fonde, sipas nevojës dhe qëllimit.

5.4 Pjesëmarrësit në tregjet financiare

Tregjet funksionojnë falë pjesëmarrjes së aktorëve që ofrojnë kapital, të atyre që kërkojnë kapital dhe ndërmjetësve financiarë.

Kategoritë kryesore të pjesëmarrësve

- ✓ **Investitorët** (zotëruesit e fondeve): individualë dhe institucionalë .
- ✓ **Huamarrësit** (ato që kanë nevojë për fonde): biznese, qeveria dhe individë.
- ✓ **Ndërmjetësit financiarë** (siguruesit e qarkullimit të fondeve): bankat tregtare, shoqëritë e sigurimeve, fondet e investimit, brokerat.

Investitorët i kategorizojmë në dy lloje:

- **Investitorë individualë** – persona që blejnë për qëllime kursimi ose fitimi personal.
- **Investitorë institucionalë** – banka, fondacione, shoqëri sigurimesh, fonde pensioni etj., që investojnë shuma të mëdha.

Në tregjet financiare një rol të rëndësishëm luajnë ndërmjetësit. Ndërmjetësit janë institucione që lehtësojnë lidhjen midis investitorëve dhe huamarrësve. Ata ulin kostot e transaksioneve, garantojnë sigurinë e operacioneve dhe rrisin besimin në treg. Si ndërmjetës kryesorë janë:

- **Bankat tregtare** – veprojnë si ndërmjetëse midis kursimtarëve dhe atyre që kanë nevojë për kredi, duke kanalizuar fondet drejt sektorëve që i përdorin ato për investime prodhuese apo shërbime.
- **Shoqëritë e sigurimeve** – mbledhin prime dhe investojnë në instrumente të sigurta.
- **Fondet e investimit** – grumbullojnë kursime të vogla dhe i investojnë në tregje.
- **Brokerat dhe agjentët financiarë** – ndërmjetësojnë blerjen e aksioneve, obligacioneve dhe letrave me vlerë në bursë.

Për të siguruar funksionimin e drejtë të tregjeve financiare, veprojnë edhe institucione publike rregullatore, të cilat monitorojnë aktivitetin financiar dhe mbrojnë investitorët. Tregjet financiare funksionojnë në mënyrë efikase vetëm nëse ekziston një bashkëpunim i ekuilibruar midis investitorëve që ofrojnë kapitalin, huamarrësve që e përdorin atë, dhe ndërmjetësve që e menaxhojnë dhe mbikëqyrin procesin. Këto institucione rregullatore janë:

- **Banka e Shqipërisë** – mbikëqyr sistemin bankar dhe politikën monetare.
- **Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)** – kontrollon tregjet e sigurimeve, fondet e investimit dhe bursat.
- **Ministria e Financave** – përcakton politikat fiskale dhe emetimin e bonove apo obligacioneve.

Pjesëmarrësit në tregjet financiare janë si hallkat e një zinxhiri ekonomik ku secili ka rolin e vet, por funksionon vetëm në bashkëveprim me të tjerët. Investitorët sigurojnë kapitalin, huamarrësit e përdorin për zhvillim, ndërmjetësit e kanalizojnë me efikasitet, ndërsa institucionet rregullatore garantojnë sigurinë dhe transparencën e tregut. Ky ekuilibër është baza e një sistemi financiar të shëndoshë dhe të qëndrueshëm, i cili krijon rrjedhë të qëndrueshme të parave, nxit zhvillimin ekonomik dhe rrit besimin në sistemin financiar.

5.5 Ndërveprimi midis tregjeve financiare dhe sistemit bankar

Tregjet financiare dhe sistemi bankar janë dy shtylla kryesore të sistemit ekonomik që funksionojnë në bashkëpunim të ngushtë për të siguruar qarkullimin efikas të kapitalit në ekonomi. Ndërveprimi midis tyre është thelbësor për zhvillimin ekonomik, stabilitetin financiar dhe krijimin e mundësive për investime.

Roli i tregjeve financiare

- ✓ Mundësojnë investime, huamarrje dhe mbledhje kapitali.
- ✓ Përfshijnë tregjet monetare, kapitalet, tregjet sekondare e primare.

Roli i sistemit bankar

- ✓ Kanalizon kursimet drejt kredive.
- ✓ Siguron likuiditet në ekonomi.
- ✓ Menaxhon rrezikun dhe stabilitetin financiar.

Ndërveprimi midis tregjeve dhe bankave

Ndërveprimi midis tregjeve financiare dhe sistemit bankar është i dyanshëm dhe i vazhdueshëm.

Forma kryesore të ndërveprimit:

- ✓ **Bankat si investitore:** blejnë bono thesari, obligacione dhe instrumente të tjera për menaxhimin e likuiditetit.
- ✓ **Tregjet si burim kapitali për bankat:** bankat mund të emetojnë aksione dhe obligacione.
- ✓ **Ndikimi i politikës monetare:** përmes operacioneve të tregut të hapur, bankat qendrore ndikojnë normat e interesit dhe likuiditetin.
- ✓ **Roli i normave të interesit:** normat e formuara në treg ndikojnë politikat e kreditimit.
- ✓ **Shkëmbimi i informacionit:** tregjet ofrojnë sinjale që bankat i përdorin për menaxhimin e rrezikut.

Nga ana tjetër, sistemi bankar ndikon drejtpërdrejt në funksionimin e tregjeve financiare. Aktivitetet e bankave, si lëshimi i kredive, normat e interesit që ato aplikojnë dhe politikat e tyre të investimit, ndikojnë në kërkesën dhe ofertën për instrumente financiare në treg. Kur bankat janë të qëndrueshme, tregjet financiare prirën të jenë më të sigurt dhe më tërheqëse për investitorët. Në nivel makroekonomik, politikat monetare të bankës qendrore ndërveprojnë me tregjet financiare përmes normave të interesit, operacioneve të tregut të hapur dhe instrumenteve të tjera. Këto politika ndikojnë drejtpërdrejt në kushtet e kreditimit, në çmimin e letrave me vlerë dhe në flukset e kapitalit në ekonomi.

Në përfundim, ndërveprimi midis sistemit bankar dhe tregjeve financiare është një proces dinamik dhe i ndërsjellë i cili krijon stabilitet dhe zhvillim ekonomik .

5.6 Rregullimi dhe mbikëqyrja e tregjeve financiare

Tregjet financiare janë një komponent thelbësor i ekonomisë së çdo vendi, pasi në to ndërmjetësohet qarkullimi i kapitalit ndërmjet kursimtarëve dhe huamarrësve. Për shkak të ndjeshmërisë së lartë që kanë, këto tregje duhet të funksionojnë mbi baza të sigurt, të rregullta dhe të besueshme. Pa rregullim dhe mbikëqyrje efektive, tregjet financiare do të ishin të ekspozuara ndaj abuzimeve, mashtrimeve, rreziqeve të larta dhe paaftësisë për të mbrojtur investitorët dhe sistemin ekonomik. Për këtë arsye, autoritetet shtetërore dhe institucionet rregullatore vendosin kuadër ligjor dhe mekanizma kontrolli që sigurojnë funksionimin korrekt të sistemit financiar.

Qëllimet kryesore të rregullimit financiar:

1. Mbrojtja e investitorëve:

Investitorët, veçanërisht ata të vegjël, shpesh nuk kanë njohuritë e nevojshme për të vlerësuar rrezikun e instrumenteve financiare. Rregullimi siguron që ata të marrin informacion të drejtë, të saktë dhe transparent nga institucionet financiare, duke reduktuar mundësinë e mashtrimeve dhe manipulimeve.

2. Parandalimi i krizave financiare:

Krizat financiare mund të përhapen shpejt në gjithë ekonominë, siç kanë treguar rastet ndërkombëtare. Për këtë arsye, rregulluesit monitorojnë rreziqet, likuiditetin dhe stabilitetin e institucioneve financiare për të parandaluar përhapjen e problemeve sistemike.

3. Rritja e transparencës:

Tregjet funksionojnë më mirë kur të gjitha palët kanë informacion të plotë dhe të barabartë. Rregullimi kërkon publikim të të dhënave të rëndësishme financiare, raportime të rregullta dhe standardizim të praktikave të raportimit.

4. Promovimi i konkurrencës së ndershme:

Autoritetet rregullatore synojnë të shmangin praktikat monopoliste, abuzimet me pozitën dominuese dhe marrëveshjet e fshehta midis institucioneve financiare. Një konkurrencë e shëndoshë sjell shërbime më cilësore dhe kosto më të ulëta për konsumatorët.

5. Kontrolli i rrezikut sistematik:

Rreziku sistematik lidhet me mundësinë që problemet e një institucioni financiar të rëndësishëm të përhapen në gjithë sistemin financiar dhe ekonominë e vendit. Për këtë, autoritetet kërkojnë që institucionet të kenë kapital të mjaftueshëm dhe të menaxhojnë me kujdes rreziqet që marrin. Mbikëqyrja financiare kryhet përmes një sërë mekanizmash dhe instrumentesh, si:

- ✓ Raportimet periodike që bankat dhe institucionet financiare janë të detyruara të dorëzojnë te autoritetet përkatëse.
- ✓ Auditimet dhe inspektimet në terren për të kontrolluar veprimtarinë e tyre reale.
- ✓ Rregullat për kapitalin minimal, që sigurojnë që institucionet financiare të jenë të afta të përballojnë humbje të papritura.
- ✓ Kontrolli i rrezikut dhe i likuiditetit, për të shmangur falimentime që mund të përhapen në të gjithë sistemin financiar.
- ✓ Sanksionet dhe ndëshkimet ligjore, për subjektet që shkelin ligjin financiar ose manipulojnë tregjet.

Mbikëqyrja e tregjeve financiare është një proces i vazhdueshëm dhe dinamik, që përshtatet me zhvillimet e reja teknologjike dhe financiare (si FinTech, kriptovalutat, etj.). Rregullimi dhe mbikëqyrja e tregjeve financiare janë elementë thelbësorë për funksionimin e shëndetshëm të ekonomisë. Ato garantojnë që tregjet të jenë të drejta, të hapura dhe të sigurta për të gjithë pjesëmarrësit. Një treg financiar i rregulluar mirë krijon besim, stabilitet dhe zhvillim ekonomik afatgjatë.

5.7 Shërbimi i klientit në institucionet financiare

Shërbimi i klientit është një nga funksionet më të rëndësishme të institucioneve financiare, pasi garanton që klientët të marrin informacion të saktë, këshillim profesional dhe mbështetje gjatë përdorimit të produkteve financiare. Në banka, shoqëri sigurimi apo fonde investimesh, shërbimi i klientit ndikon drejtpërdrejt në besimin e publikut dhe në funksionimin e qëndrueshëm të sistemit financiar. Roli kryesor i shërbimit të klientit është që të:

- ✓ ofrojë informacione të qarta dhe të sakta për produktet financiare (kredi, depozita, sigurime, investime);
- ✓ asistojë klientët në hapjen e llogarive, aplikimin për kredi ose blerjen e instrumenteve financiare;
- ✓ zgjidhë ankesat dhe problemet që lidhen me transaksionet;
- ✓ ofrojë këshillim financiar për të zgjedhur produktin më të përshtatshëm;
- ✓ sigurojë transparencë, etikë dhe mbrojtje të të dhënave personale.

Shërbimi cilësor i klientit rrit besimin në bankë ose institucion financiar, ul rrezikun e abuzimeve, si dhe ndikon në stabilitetin afatgjatë të sistemit financiar. Për këtë arsye, rregullatorët si Banka e Shqipërisë dhe AMF kërkojnë standarde të larta në komunikim, transparencë dhe trajtimin e klientëve.

5.8 Veprimtaria Praktike: Roli i shërbimit ndaj klientit në e institucione financiare

Shërbimi ndaj klientit është një element kyç i funksionimit të institucioneve financiare. Ai nuk ka vetëm një rol informues, por siguron gjithashtu që klientët të marrin produktet financiare të përshtatura për nevojat e tyre dhe të kuptojnë të gjitha aspektet e përdorimit të tyre. Një shërbim i mirë ndaj klientit rrit besimin, sigurinë dhe efektivitetin e institucioneve financiare.

Hapat e veprimtarisë praktike:

1. Përgatitja për shërbimin ndaj klientit
 - o Mësuesi ndan klasën në grupe 2-3 vetë.
 - o Çdo grup përzgjedh një rol: klient, punonjës i bankës, vëzhgues (nëse ka tre persona).
2. Informimi fillestar i klientit
 - o Punonjësi i bankës ofron informacion të qartë mbi produktet financiare (llojin e llogarive, depozitat, kreditë, investimet, sigurimet).
 - o Klienti mund të bëjë pyetje mbi afatet, normat e interesit dhe kushtet e përdorimit të produktit.
3. Këshillimi për produktin financiar
 - o Punonjësi shpjegon përfitimet dhe rreziqet e produktit që klienti dëshiron të përdorë.
 - o Klienti merr vendim mbi produktin më të përshtatshëm për nevojat e tij.
4. Plotësimi i dokumentacionit të nevojshëm
 - o Klienti dorëzon dokumentet përkatëse (identifikimi, të ardhurat, kolateralin nëse kërkohet).
 - o Punonjësi kontrollon dokumentet dhe siguron që ato të jenë të plota dhe të sakta.
5. Vlerësimi dhe komunikimi me klientin
 - o Punonjësi njofton klientin për statusin e kërkesës dhe i shpjegon hapat e mëtejshëm.
 - o Klienti mund të bëjë pyetje shtesë dhe të japë sugjerime për përmirësimin e shërbimit.

Tema 6. Tregu financiar jo bankar

6.1 Kuptimi dhe roli i tregut financiar jo bankar

Tregu financiar i një vendi përbëhet nga dy shtylla kryesore: tregu bankar dhe tregu financiar jo bankar. Nëse tregu bankar përfshin veprimtarinë e bankave që mbledhin depozita dhe japin kredi, tregu financiar jo bankar përfshin të gjitha institucionet dhe mekanizmat që ofrojnë shërbime financiare jashtë sistemit bankar tradicional.

Tregu financiar jo bankar është një segment i sistemit financiar ku zhvillohen veprimtari të ndryshme financiare që nuk lidhen drejtpërdrejt me depozita bankare ose me dhënien e kredive nga bankat. Në këtë treg veprojnë institucione që ofrojnë mënyra të tjera për investim, kursim, sigurim apo huadhënie, si:

- shoqëritë e sigurimeve;
- bursat e letrave me vlerë;
- fondet e investimeve;
- fondet e pensioneve private;
- shoqëritë e mikrofinancës dhe leasing-u.

Në thelb, tregu jo bankar krijon lidhje midis kursimtarëve dhe investitorëve, por jo përmes bankës, por përmes instrumenteve të tjerë financiarë. Tregu financiar jo bankar luan një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik, sepse plotëson dhe zgjeron funksionet e sistemit bankar. Roli i tij mund të përmblihet në disa pika kryesore:

➤ **Diversifikimi i burimeve të financimit**

Ky treg ofron mënyra alternative për të siguruar kapital — jo vetëm kredi bankare, por edhe investime përmes aksioneve, obligacioneve apo фондеve. Kështu bizneset kanë më shumë mundësi për të financuar projektet e tyre.

➤ **Rritja e konkurrencës në tregun financiar**

Duke pasur institucione të ndryshme që ofrojnë shërbime financiare, klientët përfitojnë kushte më të favorshme dhe shërbime më të lira.

➤ **Menaxhimi i rreziku**

Shoqëritë e sigurimeve dhe fondet e investimeve ndihmojnë individët dhe bizneset të mbrohen nga rreziqe të ndryshme financiare (sëmundje, dëmtime, humbje pasurie, etj.).

➤ **Zhvillimi i tregjeve të kapitaleve**

Përmes bursës dhe letrave me vlerë, ky treg ndihmon në kanalizimin e kursimeve drejt investimeve produktive, gjë që stimulon rritjen ekonomike.

➤ **Nxitja e kursimeve afatgjata**

Fondet e pensioneve dhe fondet e investimeve u mundësojnë qytetarëve të investojnë për të ardhmen e tyre, duke krijuar stabilitet financiar në nivel individual dhe kombëtar.

Tregu financiar jo bankar është një pjesë thelbësore e sistemit financiar modern. Ai nuk zëvendëson bankat, por i plotëson ato, duke ofruar mundësi më të gjera për financim, investim dhe menaxhim të rrezikut. Sa më i zhvilluar të jetë ky treg, aq më fleksibël dhe konkurrues bëhet i gjithë sistemi financiar i vendit.

6.2 Llojet e institucioneve jo bankare

Tregu financiar jo bankar përfshin një gamë të gjerë institucionesh që ofrojnë shërbime financiare pa qenë banka. Këto institucione ndihmojnë në qarkullimin e kapitalit, në sigurimin e investimeve dhe në mbrojtjen ndaj rreziqeve. Ndryshe nga bankat, ato nuk pranojnë depozita nga publiku, por veprojnë me фонде të mbledhura nga investitorë ose anëtarë të sistemit financiar.

Shoqëritë e sigurimeve

Shoqëritë e sigurimeve janë institucione që ofrojnë mbrojtje financiare ndaj rreziqeve të ndryshme që mund të prekin individët apo bizneset, si aksidentet, sëmundjet, dëmtimet e pronës apo humbja e jetës. Individët paguajnë një premium sigurimi, dhe në rast ndodhjeje të ngjarjes së pasigurt, kompania e sigurimeve dëmshpërblen klientin. Sigurimet ndahen në dy grupe kryesore:

- **Sigurime jete**

- **Sigurime jo jete**

Shoqëritë e sigurimeve kontribuojnë në stabilitetin ekonomik duke lehtësuar fondet e investimeve

Fondet e investimeve
Fondet e investimeve janë ato që mbledhin kursimet e shumë individëve dhe i investojnë në instrumente financiare si aksione, obligacione apo bono thesari. Karakteristikë e tyre është se ato menaxhohen nga, që ndajnë fitimin proporcionalisht me kontributin e çdo pjesëmarrësi. Gjithashtu ato u japin mundësi qytetarëve të marrin pjesë në tregun e kapitaleve pa pasur nevojë për njohuri të thella financiare.

Fondet e pensioneve private

Fondet e pensioneve private u mundësojnë individëve të kursejnë për moshën e pensionit, përveç skemës shtetërore. Ato karakterizohen nga fakti se:

- Kontributet depozitohen rregullisht dhe investohen në tregjet financiare për të krijuar fitim afatgjatë.
- Kur individ i del në pension, merr një pension shtesë nga fondi privat.

Kjo formë e institucioneve jo bankare ndihmon në rritjen e sigurisë sociale dhe në zhvillimin e tregjeve financiare afatgjata.

Shoqëritë e mikrofinancës

Shoqëritë e mikrofinancës janë institucione që ofrojnë kredi të vogla për persona ose biznese që nuk kanë mundësi të marrin hua nga bankat. Ato synojnë mbështetjen e sipërmarrjeve të vogla dhe shtresave me të ardhura të ulëta.

Shoqëritë e leasing-ut (qirasë financiare)

Leasing-u është një formë financimi ku një kompani i jep një aset (makineri, automjet, pajisje) një klienti për ta përdorur kundrejt pagesave periodike. Në fund të kontratës, klienti mund të zgjedhë t'a blejë mjetin ose t'a kthejë. Kjo formë është shumë e përhapur në bizneset që kanë nevojë për pajisje të shtrenjta, pa i blerë menjëherë me para cash.

Shoqëritë financiare jobankare të tjera

Në shoqëritë financiare jobankare të tjera të cilët ndihmojnë individët dhe bizneset në menaxhimin dhe investimin e fondeve përfshihen edhe:

- Shoqëritë e këshillimit financiar.
- Kompanitë e këmbimit valutë (exchange).
- Agjentët e bursës dhe ndërmjetësit financiarë.

Institucionet jo bankare janë pjesë e pandarë e sistemit financiar modern. Ato plotësojnë rolin e bankave, duke ofruar shërbime të ndryshme financiare që rrisin mundësitë për investim, kursim dhe zhvillim ekonomik. Një ekonomi me sektor jo bankar të zhvilluar është më e qëndrueshme dhe më elastike ndaj krizave financiare. Këto institucione janë të rëndësishme pasi:

- kontribuojnë në rritjen e konkurrencës financiare;
- përdorin kapital privat për zhvillim ekonomik;
- rëndojnë më pak buxhetin e shtetit;
- dhe mbulojnë segmente që bankat nuk i arrijnë dot, si grupet me të ardhura të ulëta ose bizneset e vogla.

6.3 Tregu i letrave me vlerë

Tregu i letrave me vlerë është një nga pjesët më të rëndësishme të tregut financiar jo bankar. Ai u jep mundësi individëve, bizneseve dhe qeverive të sigurojnë fonde dhe njëkohësisht të investojnë

kursimet e tyre në mënyrë të organizuar dhe të sigurt. Ky treg ndihmon në qarkullimin e kapitalit, në rritjen e investimeve dhe në zhvillimin e ekonomisë.

Letra me vlerë është një dokument financiar që përfaqëson një të drejtë pasurore, si e drejta për të marrë një shumë parash ose për të zotëruar një pjesë në kapitalin e një shoqërie. Në thelb, ato janë mjetet përmes të cilave investitorët financojnë bizneset apo qeverinë dhe, në këmbim, përfitojnë interes ose fitim. Llojet kryesore të letrave me vlerë janë:

1. **Aksionet**

- Përfaqësojnë një pjesë pronësie në një kompani.
- Personi që zotëron aksione quhet aksionar dhe mund të përfitojë dividendë (fitim nga veprimtaria e kompanisë).
- Aksionet tregtohen në bursë dhe çmimi i tyre ndryshon sipas kërkesës e ofertës.

2. **Obligacionet**

- Janë borxhe të emetuara nga qeveria ose kompani për të siguruar fonde.
- Investitori që blen një obligacion, në fakt i jep hua emetuesit dhe merr interes periodik.
- Kur obligacioni maturohet, emetuesi kthen shumën e huazuar.

3. **Bonot e thesarit**

- Janë instrumente afatshkurtra borxhi të emetuara nga shteti për të financuar nevoja të përkohshme buxhetore.
- Ato kanë risk shumë të ulët dhe konsiderohen një formë e sigurt investimi.

4. **Letra të tjera me vlerë**

- Kupona, certifikata depozite, apo instrumente të tjerë të tregtueshëm që përdoren në financa.

Tregu i letrave me vlerë ndahet në dy faza kryesore:

- **Tregu primar** – ku letra me vlerë shitet për herë të parë. Këtu emetuesi (kompania ose shteti) merr drejtpërdrejt fondet nga investitorët.
Shembull: Kur qeveria emeton bono thesari për herë të parë.
- **Tregu sekondar** – ku letrat me vlerë që janë emetuar më parë tregtohen mes investitorëve. Këtu përfshihet bursa e letrave me vlerë, ku çmimet përcaktohen nga kërkesa dhe oferta.

Rëndësia e tregut të letrave me vlerë:

Ky treg është thelbësor për funksionimin e ekonomisë moderne sepse:

- ndihmon kompanitë të rriten pa u varur vetëm nga kreditë bankare;
- krijon mundësi investimi për qytetarët dhe institucionet;
- rrit transparencën dhe efikasitetin në ekonominë kombëtare;
- ndikon në stabilitetin financiar duke shpërndarë më mirë rreziqet.

Tregu i letrave me vlerë është një mekanizëm jetik që kanalizon kursimet drejt investimeve produktive. Ai nxit zhvillimin e biznesit, gjeneron fitime për investitorët dhe ndihmon në ruajtjen e ekuilibrit financiar. Një treg i zhvilluar i letrave me vlerë është tregues i një ekonomie moderne, transparente dhe konkurruese.

6.4 Tregu i sigurimeve

Tregu i sigurimeve është një ndër shtyllat kryesore të tregut financiar jo bankar. Ai ka për qëllim të mbrojë individët, familjet dhe bizneset nga humbjet financiare që mund të shkaktohen nga ngjarje të paparashikuara si aksidente, sëmundje, dëmtime pasurie apo fatkeqësi natyrore. Përmes sigurimeve, rreziku shpërndahet ndër shumë persona, duke bërë që humbjet e një pakice të mbulohen nga kontributet e shumicës.

Sigurimi është një marrëveshje ndërmjet një individi ose institucioni (i quajtur i siguruar) dhe një shoqërie sigurimi. I siguruari paguan një prim (pagesë periodike), dhe në rast se ndodh ngjarja e rrezikut të siguruar, shoqëria i kompenson dëmin financiar. Ky mekanizëm funksionon mbi parimin e solidaritetit financiar – shumë njerëz paguajnë për të mbrojtur veten nga një rrezik që mund t'i ndodhë vetëm disa prej tyre. Në tregun shqiptar dhe ndërkombëtar, sigurimet ndahen në dy kategori kryesore:

➤ **Sigurimet e jetës**

Këto sigurime mbrojnë individin dhe familjen nga pasojat financiare që mund të shkaktojnë humbja e jetës, paaftësia për punë ose sëmundjet e rënda.

➤ **Sigurimet e jo-jetës (ose të përgjithshme)**

Këto mbulojnë dëmet në pasuri ose shëndet, si aksidentet rrugore, zjarret, përmytjet, vjedhjet, dëmtimet e ndërtesave apo të automjeteve.

Tregu i sigurimeve ka ndikim të gjerë në ekonomi dhe shoqëri pasi:

- Ndihmon në menaxhimin e rrezikut dhe ruajtjen e stabilitetit financiar të individëve dhe bizneseve.
- Inkurajon investimet, pasi bizneset ndihen më të mbrojtura ndaj humbjeve të papritura.
- Krijon fonde të mëdha financiare që investohen në tregjet e kapitalit, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit.
- Siguron qetësi sociale, pasi i siguruari ka më pak pasiguri për të ardhmen.

Në tregun e sigurimeve marrin pjesë:

- **Shoqëritë e sigurimeve**, të cilat ofrojnë produktet dhe mbulojnë rrezikun.
- **Agjentët dhe brokerat**, që ndërmjetësojnë marrëveshjet ndërmjet shoqërisë dhe klientit.
- **Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)**, që licencon, rregullon dhe mbikëqyr aktivitetin e këtyre shoqërive për të garantuar transparencë dhe mbrojtje të konsumatorëve.

6.5 Fondet e investimeve dhe fondet e pensione

Fondet e investimeve dhe fondet e pensione janë institucione shumë të rëndësishme të tregut financiar jo bankar, të cilat ndihmojnë individët të kursejnë, të investojnë dhe të sigurojnë një të ardhme më të qëndrueshme financiare. Ato luajnë rol të dyfishtë: nga njëra anë, i ndihmojnë qytetarët të rrisin kursimet e tyre, dhe nga ana tjetër, kontribuojnë në zhvillimin e tregjeve financiare përmes investimeve të mëdha në ekonomi.

Fondi i investimeve është një mjet financiar që mbledh para nga shumë investitorë dhe i investon ato në një portofol të përbashkët që përfshin aksione, obligacione, bono thesari dhe instrumente të tjera financiare. Menaxhimi i fondeve bëhet nga shoqëri profesionale të licencuara, që kanë ekspertizë në fushën e investimeve. Fitimi që krijohet nga këto investime ndahet proporcionalisht mes investitorëve, në bazë të shumës së tyre të kontribuar. Fondet e investimeve ndahen në :

- Fonde të hapura.
- Fonde të mbyllura.
- Fonde me rrezik të ulët, të mesëm ose të lartë.

Fondi i pensione është një institucion që mbledh kontribute financiare nga individët gjatë viteve të punës së tyre, me qëllim që t'u sigurojë atyre të ardhura pas daljes në pension. Ky është një sistem kursimi afatgjatë që garanton të ardhura shtesë përveç pensionit shtetëror. Paratë e mbledhura investohen në tregjet financiare, duke krijuar fitime që rrisin vlerën e pensionit të ardhshëm. Roli i këtyre fondeve në ekonomi qëndron në faktin se ato:

- Nxisin kursimin afatgjatë te individët.

- Rrisin investimet në ekonomi përmes kapitalit që menaxhojnë.
- Sigurojnë stabilitet financiar për individët në periudhën e pensionit.
- Zgjerohen tregjet e kapitalit, pasi fondet investojnë në aksione, bono dhe projekte zhvillimi.

Tema 7: Institucionet financiare jo-bankare

7.1 Kuptimi dhe roli i institucioneve financiare jo-bankare në sistemin financiar

Institucionet financiare jo-bankare (IFJB) përfaqësojnë një grup të gjerë organizatash që ofrojnë produkte dhe shërbime financiare, por që dallohen nga bankat për faktin se nuk pranojnë depozita në formën klasike dhe nuk kryejnë funksionet tradicionale të bankimit. Ato operojnë në segmentet e tjera të tregut financiar dhe plotësojnë boshllëqet që bankat nuk i mbulojnë plotësisht. Roli i tyre është të zgjerojnë mundësitë për financim, të nxisin kursimet afatgjata dhe të kontribuojnë në zhvillimin e tregjeve financiare. Duke vepruar paralelisht me bankat, këto institucione rrisin konkurrencën, diversifikojnë shërbimet dhe ndihmojnë në rritjen e stabilitetit financiar. Për këtë arsye, IFJB konsiderohen një komponent kyç i sistemit financiar modern.

Kuptimi i institucioneve financiare jo-bankare

IFJB janë institucione që ndërmjetësojnë flukset financiare midis kursyesve dhe investitorëve, duke kanalizuar kapitalin drejt nevojave të ekonomisë. Këto institucione merren me menaxhim kursimesh, transferim rreziku, financime alternative dhe investime afatshkurtra ose afatgjata. Ato ofrojnë produkte si: sigurime, pensione private, kredi të vogla, investime kolektive, qira financiare (leasing), huadhënie jo-bankare, dhe shumë shërbime të tjera që plotësojnë nevojat e tregut.

Në shumë ekonomi moderne, sidomos në ato me nivel të lartë zhvillimi financiar, institucionet jo-bankare luajnë një rol gjithmonë e më të madh në mobilizimin e kapitalit dhe në nxitjen e inovacionit financiar.

Roli i institucioneve financiare jo-bankare në sistemin financiar

Edhe pse nuk pranojnë depozita si bankat, ato ofrojnë shërbime dhe produkte që plotësojnë boshllëqet e sektorit bankar dhe mbështesin funksionimin e ekonomisë. Roli i tyre nuk është vetëm komercial; ato kontribuojnë në stabilitetin, diversitetin dhe zhvillimin e tregjeve financiare. IFJB ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh që bankat nuk i ofrojnë, si sigurime jete, sigurime pasurie, fonde investimi, pensione private, shërbime mikrokredie, këshillim financiar, etj. Kjo i lejon konsumatorët dhe bizneset të kenë shumë alternativa të ndryshme financimi dhe investimi.

Një nga funksionet më të rëndësishme të IFJB është transferimi i rrezikut nga individët ose bizneset te institucionet që e administrojnë këtë rrezik në mënyrë profesionale. Për shembull:

- shoqëritë e sigurimeve mbrojnë nga humbjet e papritura;
- fondet e pensioneve ofrojnë stabilitet financiar afatgjatë;
- fondet e investimit shpërndajnë rrezikun duke investuar në portofola të diversifikuara.

Ky funksion rrit sigurinë ekonomike të qytetarëve dhe stabilitetin e biznesit. Shumë individë, biznese të vogla apo të reja nuk mund të marrin hua nga bankat për shkak të kërkesave të larta të kolateralit. Institucionet e mikrofinancës, shoqëritë financiare apo platformat jo-bankare ofrojnë kredi më fleksibile, duke nxitur sipërmarrjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla. Fondet e pensioneve dhe fondet e investimit mobilizojnë kursime afatgjata, të cilat përdoren për të financuar investime të rëndësishme si projekte infrastrukturore, zhvillim korporatash dhe iniciativave publike. Këto kursime afatgjata janë shumë të rëndësishme për stabilitetin ekonomik të vendit.

IFJB krijojnë tregje të specializuara për sigurimet, pensionet, investimet, qiratë financiare (leasing), etj. Prania e tyre rrit konkurrencën, ul kostot e shërbimeve, rrit ofertën e produkteve dhe

thellon funksionimin e tregjeve financiare. Përmes investimeve, kredi-dhënies dhe ofrimit të shërbimeve financiare, këto institucione ndihmojnë në qarkullimin e lirë të kapitalit, duke bërë të mundur që fondet të shkojnë drejt sektorëve që kanë nevojë për to.

Pse janë të domosdoshme institucionet financiare jo-bankare?

- Ato plotësojnë hapësira të cilat bankat nuk i mbulojnë.
- Lehtësojnë qasjen në financa për shtresa më të gjera të popullsisë.
- Krijojnë stabilitet ekonomik përmes sigurimeve dhe pensioneve.
- Nxisin konkurrencën dhe inovacionin në tregun financiar.
- Ulin varësinë e sistemit financiar vetëm nga bankat.

Në një ekonomi funksionale, IFJB konsiderohen si "krahu i dytë" i sistemit financiar, pa të cilin nuk do të kishte diversitet të instrumenteve financiare dhe nuk do të kishte një zhvillim tërësor ekonomik.

7.2 Llojet kryesore të institucioneve financiare jo-bankare

Institucionet financiare jo-bankare përfshijnë një gamë të gjerë organizatash që ofrojnë shërbime financiare të specializuara. Secili lloj institucioni synon segmente të ndryshme të tregut dhe plotëson nevoja të ndryshme të individëve, bizneseve dhe investitorëve. Më poshtë paraqiten llojet kryesore të institucioneve financiare jo-bankare dhe funksioni i tyre në sistemin financiar.

Shoqëritë e sigurimeve

Shoqëritë e sigurimeve janë një nga institucionet më të rëndësishme jo-bankare. Ato ofrojnë produkte sigurimi që mbrojnë individët dhe bizneset nga rreziqe të ndryshme si aksidentet, sëmundjet, dëmtimet e pronës apo humbjet financiare. Përmes pagesës së primit, klienti transferon rrezikun te kompania e sigurimit. Shoqëritë e sigurimeve ndahen në:

- **Sigurime jete**, që ofrojnë mbrojtje financiare në rast ndodhjes së ngjarjeve të lidhura me jetën e individit.
- **Sigurime jo-jete**, ku përfshihen sigurimet e pronës, automjeteve, shëndetit, përgjegjësisë civile etj.

Roli i tyre është thelbësor sepse rrisin sigurinë ekonomike, mbrojnë konsumatorët nga humbjet e mëdha dhe kontribuojnë në stabilitetin financiar të familjeve dhe bizneseve.

Fondet e pensioneve private

Fondet e pensioneve administrojnë kursimet afatgjata të individëve për periudhën pas daljes në pension. Ato investojnë kontributet e anëtarëve në tregje financiare me qëllim që kursimet të rriten me kalimin e kohës. Përmes tyre, qytetarët sigurojnë të ardhura shtesë për moshën e tretë, duke ulur varësinë nga pensionet shtetërore. Këto fonde kanë rëndësi të madhe për zhvillimin e tregjeve financiare, sepse investojnë në instrumente afatgjata dhe krijojnë stabilitet ekonomik në afatgjatë.

Fondet e investimit

Fondet e investimit mbledhin kapital nga shumë investitorë dhe e investojnë atë në portofola të diversifikuara që përfshijnë aksione, obligacione dhe instrumente të tjera financiare. Individët që nuk kanë njohuri të avancuara financiare ose kapital të madh mund të investojnë nëpërmjet këtyre fondeve me rrezik më të ulët. Përparësitë e fondeve të investimit janë:

- diversifikimi i portofolit;
- menaxhimi profesional i investimeve;
- rrezik i reduktuar;
- akses për publikun e gjerë.

Këto institucione luajnë një rol kyç në zhvillimin e tregut të kapitaleve dhe në nxitjen e investimeve afatmesme dhe afatgjata.

Shoqëritë financiare dhe të mikroredisë (mikrofinanca)

Këto institucione ofrojnë kredi për individë dhe biznese që shpesh nuk kualifikohen për hua bankare. Ato janë veçanërisht të rëndësishme për start-up-et, bizneset e vogla, fermerët dhe individët me të ardhura të ulëta. Kreditë e mikrofinancës janë me procedura më të thjeshta, shuma më të vogla dhe kushte më fleksibile, gjë që rrit aksesin në financim për shtresat e pambuluara nga bankat. Mikrofinanca kontribuon fuqishëm në:

- uljen e varfërisë;
- promovimin e sipërmarrjes;
- rritjen e punësimit;
- zhvillimin e ekonomive lokale.

Shoqëritë e qirasë financiare (leasing)

Leasing-u është një formë financimi që i mundëson individëve ose bizneseve të përdorin një aset (si automjet, pajisje, makineri, teknologji) pa e blerë menjëherë. Klienti paguan këste të rregullta dhe në disa raste ka të drejtën ta blejë asetin në fund të kontratës. Ky shërbim është shumë i rëndësishëm për bizneset që kanë nevojë për pajisje ose mjete pune por nuk kanë kapital të menjëhershëm për t'i blerë ato. Leasing-u rrit fleksibilitetin financiar dhe lehtëson investimet.

Shoqëritë e faktoringut

Faktoringu është një shërbim ku bizneset shesin faturat e papaguara (detyrimet e klientëve) te një shoqëri financiare në këmbim të një pagese të menjëhershme. Kjo i ndihmon bizneset të marrin likuiditet të shpejtë dhe të shmangin vonesat në arkëtimin e parave. Roli i faktoringut është i rëndësishëm sidomos për bizneset e vogla, të cilat shpesh përballen me mungesë likuiditeti.

Institucionet e financimit të specializuar

Këtu përfshihen institucione që merren me financimin e sektorëve specifikë, si p.sh.:

- financimi i pasurive të paluajtshme;
- financimi i bujqësisë;
- financimi i arsimit;
- kreditimi konsumer.

Ato ofrojnë produkte të konceptuara posaçërisht për nevojat e këtyre sektorëve dhe ndihmojnë në rritjen e investimeve në fusha me rëndësi të veçantë.

Platformat fintech (financat digjitale)

Këto janë institucione moderne jo-bankare që përdorin teknologjinë për të ofruar shërbime financiare, si:

- pagesa elektronike;
- kreditim online;
- investime digjitale,
- këmbim valutor elektronik;
- portofola elektronikë (e-wallets).

Fintech po transformon mënyrën se si njerëzit kryejnë transaksione financiare, duke i bërë ato më të shpejta, më të lira dhe më të aksesueshme. Si përfundim mund të themi se llojet e institucioneve financiare jo-bankare janë të ndryshme dhe të specializuara, duke mbuluar funksione që bankat nuk i sigurojnë. Ato rrisin konkurrencën, thellojnë tregjet financiare, ulin rreziqet dhe krijojnë mundësi më të gjera për financim, kursime dhe investime. Prania e tyre është e domosdoshme për një ekonomi moderne dhe për zhvillimin e qëndrueshëm financiar.

7.3 Funksionet dhe shërbimet që ofrojnë institucionet financiare jo-bankare

Institucionet financiare jo-bankare (IFJB) luajnë një rol thelbësor në sistemin financiar, sepse ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh që plotësojnë ose zëvendësojnë funksionet e bankave. Ato plotësojnë boshllëqet që bankat nuk i mbulojnë dhe u shërbejnë individëve, bizneseve dhe tregut financiar në mënyra alternative dhe të specializuara. Funksionet dhe shërbimet e tyre janë të larmishme dhe ndikojnë ndjeshëm në qarkullimin e kapitalit, menaxhimin e rrezikut dhe zhvillimin ekonomik. Një nga funksionet kryesore të IFJB është ndërmjetësimi midis atyre që kanë fonde (kursyesit) dhe atyre që kanë nevojë për fonde (bizneset dhe individët). Edhe pse nuk pranojnë depozita si bankat, ato mobilizojnë kapital në forma të tjera, si:

- kontribute pensioni;
- prime sigurimi;
- kuota investimi në fondet kolektive;
- kapital investitorësh privatë;
- tarifa të shërbimeve financiare.

Kështu ato sigurojnë qarkullimin e vazhdueshëm të kapitalit në ekonomi dhe krijojnë mundësi financimi për segmente të ndryshme të tregut.

Një funksion tjetër shumë i rëndësishëm është menaxhimi i rrezikut, i cili realizohet në mënyra të ndryshme në varësi të llojit të institucionit.

- Shoqëritë e sigurimeve ulin pasigurinë financiare duke e transferuar rrezikun te kompania e sigurimit.
- Fondet e investimit diversifikojnë portofolin e investitorëve, duke ulur ndikimin e rrezikut të tregut.
- Fondet e pensioneve sigurojnë stabilitet financiar në të ardhmen, duke minimizuar rrezikun e mungesës së të ardhurave në moshën e tretë.

Ky proces është i domosdoshëm për një ekonomi të qëndrueshme, sepse ndihmon në shmangien e humbjeve të mëdha individuale dhe nga ana tjetër rrit besimin e publikut në sistemin financiar. IFJB ofrojnë financime që shpesh bankat nuk i japin, për shkak të kriterëve të rrepta ose mungesës së kolateralit. Disa forma financimi alternative përfshijnë:

- kreditë e mikrofinancës;
- huatë konsumatore nga shoqëritë financiare;
- qira financiare (leasing);
- faktoring për bizneset;
- financime të specializuara për bujqësinë, teknologjinë, arsimin ose start-up-et.

Falë këtyre formave, shumë individë dhe biznese arrijnë të marrin fonde dhe të zhvillohen edhe kur sistemi bankar nuk u ofron mbështetje.

Institucionet si fondet e investimit dhe fondet e pensioneve mbledhin kursimet e individëve dhe i investojnë ato në tregje financiare, duke kontribuar në zhvillimin e tyre afatgjatë. Ato ofrojnë:

- mundësi për kursime afatgjata;
- akses për investime profesionale;
- portofola të diversifikuar;
- kthime potencialisht më të larta sesa depozitat bankare.

Ky funksion forcon stabilitetin ekonomik dhe krijon burime të rëndësishme për financimin e projekteve të mëdha në ekonomi. Shumë institucione jo-bankare, veçanërisht ato fintech, ofrojnë shërbime moderne pagesash, të cilat e bëjnë më të shpejtë dhe më të lirë kryerjen e transaksioneve. Këto shërbime përfshijnë:

- pagesa elektronike;
- portofola digjitale (e-wallets);
- transfertat online;
- platforma peer-to-peer (P2P).

Duke lehtësuar pagesat, ato rrisin qarkullimin financiar dhe ndihmojnë tranzicionin drejt ekonomisë digjitale. Disa institucione jo-bankare ofrojnë shërbime profesionale këshillimi për individë dhe biznese. Këto shërbime ndihmojnë individët të marrin vendime më të informuara dhe i ndihmojnë bizneset të përmirësojnë performancën financiare. Me praninë e tyre në treg, IFJB nxisin konkurrencë midis institucioneve financiare, duke çuar në:

- ulje tarifash;
- përmirësim shërbimesh;
- inovacione të reja financiare;
- digjitalizim të shpejtë.

Kjo sjell përfitime të drejtpërdrejta për konsumatorët dhe zhvillimin e tregut financiar në përgjithësi. Funkcionet dhe shërbimet e institucioneve financiare jo-bankare janë të domosdoshme për funksionimin e një sistemi financiar modern. Ato ndërmjetësojnë kapitalin, menaxhojnë rrezikun, ofrojnë financime alternative, nxisin kursimet dhe investimet, dhe kontribuojnë në inovacionin dhe stabilitetin e tregjeve financiare. Në këtë mënyrë, ato plotësojnë dhe forcojnë rolin e bankave, duke siguruar një ekonomi më të qëndrueshme dhe më dinamike.

7.4 Rregullimi dhe mbikëqyrja e institucioneve financiare jo-bankare.

Institucionet financiare jo-bankare (IFJB) përbëjnë një pjesë të rëndësishme të sistemit financiar, ndaj funksionimi i tyre kërkon rregulla të qarta dhe mbikëqyrje të vazhdueshme. Edhe pse nuk pranojnë depozita si bankat, ato kryejnë veprimtari të ndjeshme si dhënia e kredive, investimet, sigurimi, pensionet private apo shërbimet e pagesave. Për këtë arsye, shteti dhe autoritetet mbikëqyrëse kanë krijuar një kuadër ligjor që siguron që këto institucione të jenë të sigurta, të qëndrueshme dhe në shërbim të konsumatorëve. Qëllimi i rregullimit të institucioneve jo-bankare ka dy synime kryesore:

a) Mbrojtja e konsumatorëve

Shumë qytetarë përdorin shërbime nga institucione të tilla si:

- kompanitë e sigurimit;
- shoqëritë e kursim-kreditit;
- shoqëritë e mikrofinancës;
- fondet e pensioneve private;
- institucionet e pagesave.

Për të shmangur abuzimet, tarifat e padrejta, kontratat e ndërlikuara apo praktikatat e pandershme, ligji kërkon transparencë, shpalljen e riskut dhe mbrojtjen e të dhënave të konsumatorit.

b) Sigurimi i stabilitetit financiar

Edhe pse këto institucione nuk kanë madhësinë dhe rrezikun e bankave, problemet në tregjet e sigurimeve apo në mikrofinancë mund të dëmtojnë gjithë ekonominë. Rregullimi siguron që:

- institucionet të kenë kapital të mjaftueshëm;
- të raportojnë rreziqet në mënyrë të rregullt;
- të menaxhojnë me kujdes fondet e klientëve;
- të shmangin rrezikun e falimentimit.

Në Shqipëri, mbikëqyrja e institucioneve financiare jo-bankare kryhet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF). AMF mbikëqyr:

- tregun e sigurimeve;
- fondet e pensioneve private;
- tregun e titujve (bursat dhe ndërmjetësit);
- shoqëritë e mikrofinancës dhe faktoringut;
- shoqëritë e qiradhënies financiare (leasing).

Rregullimi dhe mbikëqyrja e institucioneve financiare jo-bankare është një proces thelbësor për funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit financiar. Përmes rregullave të qarta, licencimit të kujdesshëm, kontrollit të brendshëm dhe inspektimeve të rregullta, institucione të tilla si shoqëritë e sigurimit, mikrofinancat, fondet e pensioneve apo institucionet e pagesave operojnë në mënyrë të sigurt dhe në interes të konsumatorëve. Në këtë mënyrë, sistemi financiar ofron më shumë mundësi, transparencë dhe besueshmëri për qytetarët dhe bizneset.

7.5 Rreziqet dhe sfidat që lidhen me institucionet financiare jo-bankare

Institucionet financiare jo-bankare (IFJB) luajnë një rol të rëndësishëm në zgjerimin e aksesit në financa dhe në diversifikimin e tregut financiar. Megjithatë, veprimtaria e tyre shoqërohet edhe me rreziqe dhe sfida specifike, të cilat duhen menaxhuar me kujdes për të garantuar stabilitetin financiar dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Ndryshe nga bankat, këto institucione nuk kanë gjithmonë të njëjtin nivel kontrolli, kapitali dhe përvojë, ndaj janë më të ekspozuara ndaj zhvillimeve të papritura në treg. Kuptimi i rreziqeve të tyre është i domosdoshëm për studentët, politbërësit dhe vetë institucionet. Rreziqet dhe sfidat që lidhen me institucionet financiare jo-bankare mund të jenë:

➤ Rreziku i kreditit

Shumë institucione jo-bankare ofrojnë hua, sidomos shoqëritë e mikrofinancës dhe ato të kursim-kreditit. Këto institucione shpesh i drejtohen klientëve me të ardhura të ulëta, pa garanci të mjaftueshme dhe me histori kredie të pasigurt. Për pasojë:

- ekziston rreziku që klientët të mos i kthejnë kreditë në kohë;
- humbjet financiare mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë e institucionit;
- një rritje masive e kredive me probleme mund të krijojë papërgjegjshmëri në treg.

➤ Rreziku operacional

Ky rrezik lidhet me gabimet njerëzore, problemet teknologjike dhe proceset e brendshme. Për shembull:

- një shoqëri e pagesave që vuan një defekt në sistemet elektronike mund të shkaktojë vonesa në transfertat e parave;
- gabimet në dokumentacion mund të sjellin humbje;
- mungesa e trajnimit të personelit rrit shanset e abuzimeve ose mashtrimeve.

IFJB-të, sidomos ato të vogla, shpesh nuk kanë burime të mjaftueshme për investime në teknologji dhe kontroll të brendshëm.

➤ Rreziku i likuiditetit

Institucionet jo-bankare mund të hasin vështirësi në plotësimin e detyrimeve të tyre afatshkurtra, sidomos kur:

- varen nga financime të jashtme (donacione, kredi nga bankat, ose investitorë);
- vërehet ulje e papritur e të ardhurave;
- klientët kërkojnë pagesa apo shërbime në volum më të madh se zakonisht.

Në rast mungese likuiditeti, instituti mund të dëmtojë reputacionin ose të rrezikojë operimin.

➤ Rreziku i tregut

Ky rrezik lidhet me luhatjet e normave të interesit, kursit të këmbimit ose çmimeve të aseteve, pasi mund të çojnë në faktin që:

- fondet e pensioneve mund të përballen me ulje të vlerës së investimeve;
- shoqëritë e sigurimeve mund të preken nga ndryshimet në normat e interesit që ndikojnë te investimet e tyre në bono dhe obligacione;
- institucionet që financohen në valutë mund të pësojnë humbje nëse kursi i këmbimit lëviz negativisht.

➤ Rreziku i reputacionit

Nëse një institucion përfshihet në skandale financiare, mashtrime, abuzime ndaj klientëve, vonesa në shërbime, atëherë besimi i konsumatorëve bie ndjeshëm. Për shkak se IFJB-të konkurrojnë për besim dhe stabilitet, dëmtimi i reputacionit mund të çojë në humbjen e klientëve dhe ulje të të ardhurave.

➤ Rreziku i përputhshmërisë me ligjin

Institucionet jo-bankare duhet të zbatojnë rregulla të shumta që lidhen me mbrojtjen e konsumatorit, parandalimin e pastrimit të parave, transparencën e tarifave, raportimin financiar. Çdo shkelje sjell gjoba, kufizim aktiviteti apo humbje licence. Për shumë IFJB të vogla, përballja me ndryshimet e vazhdueshme ligjore është një sfidë e madhe. Rreziku i mashtrimit dhe pastrimit të parave: Për shkak të procedurave më fleksibile, IFJB-të janë më të prekshme nga:

- transaksione të dyshimta;
- përdorimi i shërbimeve të tyre për fshehje fondesh;
- mashtrime nga klientët apo punonjësit.

Prandaj kërkohet sistem i fortë verifikimi, njohje e klientit dhe monitorim transaksionesh.

➤ Sfidat teknologjike dhe dixhitalizimi

Me rritjen e shërbimeve online, institucionet jo-bankare duhet të investojnë në siguri kibernetike, sisteme moderne pagesash dhe platforma digjitale të sigurta. Pa këto investime, ato mbeten të pambrojtura ndaj sulmeve kibernetike ose humbasin konkurrencën në treg.

➤ Konkurrenca e lartë dhe presioni i tregut

IFJB-të shpesh operojnë në tregje të ngushta ku produktet janë të ngjashme, marzhet e fitimit janë të ulëta dhe klientët kanë mundësi të shumta zgjedhjeje. Kjo i detyron institucionet të ulin tarifa ose të marrin rreziqe më të mëdha për të tërhequr klientë.

➤ Sfidat e qeverisjes së brendshme

Shumë institucione të vogla ballafaqohen me mungesë ekspertize në menaxhim, vendimmarrje jo-profesionale, struktura të dobëta kontrolli të brendshëm dhe konflikte interesi. Qeverisja e dobët çon shpesh në vendime të rrezikshme që ndikojnë te stabiliteti i institucionit.

Institucionet financiare jo-bankare ofrojnë mundësi të mëdha për zhvillimin ekonomik dhe përfshirjen financiare, por ato përballen me rreziqe të larta dhe sfida të vazhdueshme. Menaxhimi i kujdesshëm i rrezikut, rritja e transparencës, forcimi i qeverisjes së brendshme dhe investimet në teknologji janë çelësi për operimin e suksesshëm dhe të sigurt të tyre.

7.6 Roli i institucioneve financiare jo-bankare në zhvillimin ekonomik

Institucionet financiare jo-bankare (IFJB) janë një pjesë thelbësore e sistemit financiar modern dhe ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të një vendi. Edhe pse nuk kryejnë funksionet tradicionale të bankave, ato ofrojnë shërbime financiare të specializuara që rrisin

efikasitetin, konkurrencën dhe përfshirjen financiare. Në shumë vende në zhvillim, këto institucione janë një forcë shtytëse e ekonomisë, duke i ofruar mundësi individëve dhe bizneseve që bankat shpesh nuk i mbulojnë. Roli i institucioneve financiare jo-bankare në zhvillimin ekonomik konsiston në:

- Rritjen e aksesit në financa - Një nga kontributet më të rëndësishme të IFJB-ve është aftësia për t'u dhënë mundësi financiare popullatës dhe bizneseve që kanë vështirësi në aksesimin e kredive bankare. Kjo rrit përgjithësisht përfshirjen financiare dhe nxit zhvillimin lokal.
- Mbështetja e sipërmarrjes së vogël dhe punësimit - Microfinance, shoqëritë e kursim-kreditit dhe institucionet e leasing-ut janë burime kryesore financimi për ndërmarrjet e vogla dhe për individët që aspirojnë të nisin biznesin e tyre. Falë tyre krijohen biznese të reja, zgjerohen aktivitetet ekzistuese, hapen vende pune dhe rritet produktiviteti i ekonomisë.
- Diversifikimi i sistemit financiar. Një sistem financiar i shëndetshëm ka nevojë për shumëllojshmëri institucionesh. IFJB-tën rrisin konkurrencën në treg, ulin kostot e shërbimeve financiare, sjellin produkte të reja si faktoring, leasing, sigurime specifike, platforma digjitale pagesash dhe stimulojnë inovacionin financiar.
- Menaxhimi i rrezikut në ekonomi. Institucionet e sigurimeve, fondet e pensioneve dhe fondet e investimit kontribuojnë në stabilitet ekonomik përmes mbrojtjes nga rreziqet (sëmundjet, aksidentet, dëmet, humbjet financiare), sigurimit të të ardhurave të qëndrueshme në të ardhmen (pensione) dhe investimeve të qëndrueshme dhe afatgjata në tregje kapitale.
- Mobilizimi i kapitalit dhe rritja e investimeve. Fondet e investimit, fondet e pensioneve dhe shoqëritë e sigurimit mbledhin kapital nga qindra mijëra individë dhe biznese. Ky kapital investohet në tregjet financiare, mbështet projektet infrastrukturore, financon ndërmarrjet e mëdha dhe të vogla dhe krijon burime të reja financiare për zhvillim.
- Nxitja e inovacionit dhe digjitalizimit. Shumë prej institucioneve jo-bankare, veçanërisht fintech-et dhe platformat e pagesave, kanë sjellë ndryshime të mëdha në mënyrën si kryhen shërbimet financiare pagesa të shpejta online, portofola digjitale (e-ëallets), aplikacione për kredi të menjëhershmeshërbime,etj.
- Përmirësimi i stabilitetit ekonomik social. Përmes shërbimeve të sigurimit dhe pensioneve, IFJB-të zvogëlojnë varfërinë, ofrojnë siguri sociale, mbrojnë familjet nga ngjarjet e papritura dhe rrisin mirëqenien ekonomike afatgjatë. Një popullsi e mbrojtur financiarisht është më produktive dhe me rrezik më të ulët borxhi.
- Kontributi në zhvillimin rajonal dhe rural. Shumë IFJB operojnë në zona të thella rurale, komunitete të izoluara apo rajone ku bankat nuk kanë degë. Në këto kushte ato financojnë bujqësinë, përmirësojnë jetesën e familjeve rurale si dhe nxisin zhvillimin e tregjeve lokale. Kjo ndihmon në uljen e emigrimit dhe në krijimin e ekonomive të qëndrueshme komunitare.

Siç e shohim roli i institucioneve financiare jo-bankare në zhvillimin ekonomik është shumëdimensional dhe thelbësor. Ato zgjerojnë aksesin në financa, mbështesin sipërmarrjen, rrisin konkurrencën dhe inovacionin, krijojnë siguri financiare për individët dhe kontribuojnë në stabilitetin afatgjatë të ekonomisë. Në kombinim me bankat, ato formojnë një sistem financiar më të fortë, më gjithëpërfshirës dhe më fleksibël.

Tema 8: Zhvillimi dhe teknologjia në sistemin bankar

8.1 Roli dhe rëndësia e teknologjisë në sistemin bankar

Ekonomia e vendit tonë, gjatë njëzet viteve të fundit, është ballafaquar me probleme të shumta. Ndryshimet e sistemeve, nga totalitare e centralizuar, drejt ekonomisë së tregut u shoqëruan me ngjarje, të cilat patën ndikime të rëndësishme në ekonominë shqiptare. Një nga më thelbësoret për perspektivën e të ardhmes ishte teknologjia. Në këtë aspekt, vihet re se paraja po bëhet gjithmonë e më shumë elektronike. Duke u fokusuar në sektorin financiar, interneti mund t'u sigurojë bankave një skenar të plotë të mundësive dhe potencialit ekonomik që sjellin risi në produkte, procesin e shpërndarjes dhe marketingut. Rruga që përshkohet, nga bankat tradicionale drejt atyre virtuale, të cilat nuk mundësojnë sportele fizike apo infrastrukturë bankare reale, kalon përmes internet banking. Si asnjëherë më parë, në Shqipëri ofrohet kryerja on-line e transaksioneve të pagesave. Ky shërbim ka për qëllim minimizimin e humbjes së kohës dhe aspektet e burokracive të banking-ut tradicional. Historia e viteve të fundit tregon, se, në të ardhmen, kategoritë e shërbimeve bankare do të kenë funksione plotësuese të bankave tradicionale.

Teknologjia ka **modernizuar**, **demokratizuar** dhe **globalizuar** sistemin financiar, duke e bërë më efikas, të sigurt, gjithëpërfshirës dhe inovativ. Teknologjia ka transformuar në mënyrë të thellë sistemin financiar global, duke e bërë atë më të shpejtë, më efikas dhe më të arritshëm për të gjithë. Ajo ka ndryshuar mënyrën se si njerëzit kursejnë, investojnë, kryejnë pagesa dhe marrin kredi. Sot, shumica e transaksioneve financiare realizohen në mënyrë digjitale përmes bankave online, aplikacioneve mobile dhe platformave fintech (financial technology).

Falë inovacionit teknologjik, pagesat ndërkombëtare kryhen në kohë reale, shkëmbimi i të dhënave është më i sigurt përmes kriptimit dhe teknologjive blockchain (një mënyrë moderne për ruajtjen dhe shkëmbimin e të dhënave në mënyrë të sigurt, transparente dhe të pandryshueshme), ndërsa inteligjenca artificiale ndihmon në parashikimin e rreziqeve dhe personalizimin e shërbimeve.

Ky transformim ka rritur përfshirjen financiare, duke u mundësuar edhe individëve në zona të largëta të kenë akses në shërbime bankare përmes teknologjisë. Në të njëjtën kohë, konkurrenca mes bankave tradicionale dhe kompanive FinTech (Financial Technology) ka nxitur inovacionin, transparencën dhe uljen e kostove. Teknologjia ka shndërruar sistemin financiar global në një rrjet të integruar, të lidhur dhe dinamik, ku shërbimet financiare janë më të sigurta, më të shpejta dhe më të përshtatura me nevojat e përdoruesve.

8.2 Dallimet ndërmjet sistemit tradicional dhe atij digjital

Dallimi ndërmjet sistemit tradicional dhe atij digjital është shumë i rëndësishëm sepse tregon mënyrën se si zhvillohet sektori bankar dhe se si ndryshon përvoja e klientit në përputhje me kohën dhe teknologjinë.

Karakteristikat	Sistemi tradicional	Sistemi digjital / bankë elektronike
Aksesueshmëria	I kufizuar në orarin zyrtar të bankës dhe në vendndodhjen e saj.	Akses 24 orë në ditë, 7 ditë në javë nga çdo vend me lidhje interneti.
Nevoja për degë fizike	Të domosdoshme për shumicën e operacioneve.	Nuk është e domosdoshme, shumë operacione bëhen online.

Karakteristikat	Sistemi tradicional	Sistemi digjital / bankë elektronike
Teknologjia dhe sistemet e vjetra	Infrastrukturë e trashëguar, sfiduese në përditësim.	Teknologji bashkëkohore dhe procese të automatizuara.
Koha e shërbimit / procesit	Shumëherë më e gjatë (formularë, verifikime fizike).	Transaksione dhe shërbime që kryhen me shpejtësi të lartë.
Tarifat / kostot	Shpenzime më të larta operative për degët, stafin.	Kosto operacionale më të ulëta sipas modelit digjital.
Përvoja e klientit	Shërbim personal dhe ndërveprim i drejtpërdrejtë me punonjësit.	Shërbim më i shpejtë, personalizim automatik dhe ndërveprim përmes platformave digjitale.
Siguria	Fokus në sigurinë fizike dhe procedurës.	Fokus në sigurinë kibernetike, biometrika, enkriptim.

8.3 Shërbimi bankar dixhital. Transformimi digjital në sektorin bankar në Shqipëri

Sektori bankar në Shqipëri po kalon një transformim të shpejtë, me shërbimin digjital që po bëhet një pjesë e rëndësishme e menaxhimit të financave personale dhe të biznesit. **Shërbimi bankar digjital** i referohet përdorimit të platformave online dhe aplikacioneve mobile për të menaxhuar llogaritë bankare, për të kryer pagesa dhe për të përdorur shërbime të tjera financiare pa pasur nevojë të vizitoni një degë bankare. Disa nga veçoritë më të njohura të shërbimi bankar digjital përfshijnë:

- Aplikacione bankare në celular (Hyni në llogarinë tuaj kudo, kurdo).
- Pagesa pa kontakt (Transaksione më të shpejta dhe më të sigurta).
- Transferta të menjëhershme (Dërgoni dhe pranoni para në një kohë shumë të shpejtë).
- Pagesa faturash online (Paguani faturat e ujit, dritave dhe shërbimeve të tjera me vetëm disa klikime).
- Mënyra të sigurta hyrjeje (Identifikim biometrik dhe verifikim me dy faktorë për mbrojtje të shtuar).

E ardhmja e shërbimit bankar digjital në Shqipëri

Transformimi i shërbimit bankar digjital sapo ka filluar. Në vitet e ardhshme, pritet:

- Më shumë transaksione pa para në dorë – Shqipëria po ecën drejt një ekonomie digjitale.
- Veçori më të avancuara të bankimit mobile – Mjete të reja për menaxhimin e financave personale.
- Integrim më i mirë mes pajisjeve – Lidhje më e lehtë midis desktopit, celularit dhe ATM-ve.
- Transaksione më të shpejta dhe më të sigurta – Përditësime të vazhdueshme për të rritur sigurinë.

Një sistem pagesash elektronike nuk është vetëm më eficient në kosto, por gjithashtu, prodhon transparencë dhe mekanizëm monitorimi të fortë për sistemin e taksave.

8.4 Makineritë detektuese (të parave të falsifikuara) dhe të numërimit, funksionet

Makineritë detektuese dhe të numërimit të parave të falsifikuara janë pajisje të rëndësishme në sistemin financiar që automatizojnë procesin e numërimit të vëllimeve të mëdha të parave të gatshme, duke verifikuar njëkohësisht vërtetësinë e secilës kartëmonedhë. Ato përdoren gjerësisht

nga bankat, shitësit me pakicë, kazinotë dhe biznese të tjera që lëvrojnë sasi të konsiderueshme parash për të rritur efikasitetin, për të minimizuar gabimet njerëzore dhe për të luftuar mashtrimin financiar.

Funksionet kryesore:

Numërim efikas: Funksioni kryesor është të numërojë me saktësi dhe shpejtësi sasi të mëdha kartëmonedhash, duke kursyer kohë krahasuar me numërimin manual.

Zbulimi i falsifikimit: Ato përdorin teknologji të shumëfishta të avancuara sensorësh për të shqyrtuar tiparet e sigurisë të integruara në kartëmonedhat origjinale dhe për të shënuar çdo gjë që nuk i kalon testet.

Renditja dhe grumbullimi: Shumë modele të përparuara mund të rendisin kartëmonedhat sipas prerjes, orientimit ose përshtatshmërisë (duke identifikuar kartëmonedhat e ndotura ose të grisura) dhe të numërojnë kartëmonedhat në madhësi specifike për t'u paketuar.

Gjurmimi i numrit serial: Disa makina të nivelit të lartë regjistrojnë numrat serialë të kartëmonedhave, duke ofruar një siguri shtesë dhe gjurmueshmërie për auditimet dhe menaxhimin e parave të gatshme.

Integrimi: Makinat moderne shpesh integrohen me sistemet e pikave të shitjes (POS) dhe softuerët financiarë, duke lejuar sinkronizimin e të dhënave në kohë reale dhe raportimin financiar gjithëpërfshirës.

8.5 Rëndësia e makinerive detektuese (të parave të falsifikuara) dhe të numërimit

Përdorimi i makinerive detektuese dhe të numërimit të kartëmonedhave rrit saktësinë, shpejtësinë, sigurinë dhe efikasitetin ekonomik të sistemit financiar, duke ulur humbjet nga paratë e falsifikuara, gabimet njerëzore dhe kohën e punonjësve të harxhuar për veprime rutine. Rëndësia e makinerive detektuese të parave (kundër falsifikimeve):

- **Parandalojnë humbjet financiare.** Parandalojnë humbjet financiare duke mundësuar zbulimin e hershëm të kartëmonedhave të falsifikuara, duke shmangur pranimin dhe regjistrimin e tyre si të vlefshme dhe redukton humbjet e drejtpërdrejta për biznesin.
- **Rritin besueshmërinë dhe reputacionin.** Klientët dhe partnerët ndihen më të sigurt kur biznesi përdor metoda të besueshme për të kontrolluar paratë.
- **Reduktojnë punën e stafit.** Automatizimi i kontrollit heq barrën e përvojave manuale të identifikimit dhe minimizon gabimet njerëzore.
- **Përputhje me rregulloret dhe procedurat.** Në disa sektorë (bankë, shitje me shumicë etj) kontrolli i parave është pjesë e procedurave të auditit dhe të luftës kundër krimit financiar.
- **Kapacitet të lartë detektimi.** Pajisjet moderne për identifikimin e banknotave të falsifikuara përdorin disa teknologji njëkohësisht si ultravjollcë (UV), infra të kuqe (IR), sensorë magnetikë, analiza të ngjyrave etj. Në praktikë, kur një pajisje inspekton një kartëmonedhë, ajo krahason elementet fizike dhe optike të saj me parametrat e pritura; nëse ndonjë element nuk korrespondon, pajisja jep alarm duke reduktuar gabimet njerëzore dhe rritur sigurinë kundër falsifikimit. Rëndësia e makinerive të numërimit:
- **Shpejtësi dhe efikasitet.** Numërimi automatik është shumë më i shpejtë se numërimi manual.
- **Saktësi e lartë.** Redukton gabimet e numërimit manual.
- **Shkurtojnë kohën e punonjësve.** Automatizimi ul kohën e punës rutinë, duke u lejuar punonjësve të fokusohen në detyra me vlerë të shtuar si shërbimi ndaj klientit dhe kontrolli i inventarit.

- **Raportim dhe auditim.** Shumë makina ofrojnë raporte të sakta (numër, vlerë totale, lloje monedhash), të cilat lehtësojnë auditimet e brendshme dhe përputhjet me regjistrimet financiare.
- **Detektimi i përzierjeve/gabimeve.** Pajisjet më të avancuara identifikojnë se ku ka përzierje të kartëmonedhave të dëmtuara, dhe i nxjerrin jashtë për verifikim.

Tema 9: Rëndësia e burimeve njerëzore në institucionet financiare

9.1 Tendencat e burimeve njerëzore në institucionet financiare

Menaxhimi i burimeve njerëzore është pjesë e rëndësishme e funksionit të procesit të menaxhimit, selektimit, trajnimit dhe zhvillimit të forcës punëtore dhe është një mjet i rëndësishëm strategjik që ndihmon në zhvillimin e qëndrueshëm të institucioneve financiare. **Menaxhimi i burimeve njerëzore** përfshin një sërë aktiviteteve që synojnë maksimizimin e produktivitetit dhe performancës së punonjësve duke krijuar gjithashtu një mjedis pozitiv pune.

Me përparimin e teknologjisë, ndryshimin e pritshmërive të klientëve dhe reformave rregullatore, industria bankare dhe ajo financiare vazhdon të evoluojë. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, edhe praktikatat e burimeve njerëzore në këtë sektor janë transformuar. Disa nga tendencat që po formësojnë burimet njerëzore në industrinë bankare dhe financiare janë:

Transformimi Digjital – Burimet njerëzore po përdorin teknologjinë, sistemet “cloud” dhe automatizimin për të rritur efikasitetin dhe për të thjeshtuar proceset. Punonjësit aksesojnë informacion përmes portaleve dhe sistemeve online.

Fokus te mirëqenia e punonjësve - Promovohet balanca punë-jetë, mbështetje për shëndetin mendor dhe krijimi i një kulture mbështetëse që nxit angazhim dhe motivim.

Analiza e avancuar e të dhënave – Burimet njerëzore përdorin të dhënat për të analizuar performancën, angazhimin dhe lëvizjen e stafit, duke marrë vendime të bazuara në fakte për menaxhimin e prioritetëve.

Rikualifikimi dhe përmirësimi i aftësive (Upskilling & Reskilling) - Ofrohen trajnime për zhvillim profesional dhe për t’u përshtatur me kërkesat teknologjike dhe për të ruajtur konkurrueshmërinë.

Diversiteti dhe përfshirja - Sigurohen mundësi të barabarta për punësim dhe zhvillim për individë nga kultura të ndryshme, duke nxitur inovacion dhe vendimmarrje të duhur.

Menaxhimi i ndryshimeve – Burimet njerëzore ndihmojnë organizatat të përshtaten me ndryshimet teknologjike dhe rregullatore përmes komunikimit, trajnimeve dhe mbështetjes së vazhdueshme.

Menaxhimi i burimeve njerëzore luan një rol strategjik në zhvillimin, motivimin dhe qëndrueshmërinë e institucioneve financiare, duke u përshtatur me trendet dhe sfidat e epokës digjitale.

9.2 Vlerësimi, motivimi dhe zgjidhja e problemeve

Në institucionet financiare, ku saktësia, përgjegjësia dhe besimi i klientëve janë një element mjaft i rëndësishëm, **vlerësimi, motivimi dhe aftësia për zgjidhjen e problemeve** luajnë një rol shumë të rëndësishëm në suksesin e punonjësve dhe zhvillimin e institucionit.

Vlerësimi i performancës - Vlerësimi i rregullt i punonjësve ndihmon në matjen e performancës, identifikimin e pikave të forta dhe dobësive, si dhe në përcaktimin e objektivave të zhvillimit.

Përmes këtij procesi, menaxherët ofrojnë feedback konstruktiv dhe hartojnë plane trajnimi apo zhvillimi profesional. Kështu sigurohet përmirësim i vazhdueshëm dhe përshtatje e performancës individuale me objektivat strategjike të institucionit.

Shembull për ilustrim: Në Raiffeisen Bank Albania, çdo vit zhvillohet procesi i vlerësimit të performancës përmes platformës digjitale të burimeve njerëzore. Punonjësit vendosin objektivat individuale në fillim të vitit dhe në fund marrin feedback nga menaxherët mbi arritjet dhe fushat për përmirësim. Ky proces ndihmon në identifikimin e atyre që mund të promovohen ose të përfitojnë trajnim shtesë në fusha si analiza financiare apo menaxhimi i riskut.

Motivimi - Motivimi është forca që nxit punonjësit të japin maksimumin. Në sektorin financiar, ku puna shpesh është kërkuese dhe konkurruese, motivimi i *brendshëm* (si kënaqësia personale dhe vlerësimi) dhe i *jashtëm* (si shpërblimet, bonuset dhe promovimet) janë thelbësorë. Punonjësit e motivuar tregojnë produktivitet më të lartë, përkushtim dhe kreativitet, ç'ka ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimit dhe reputacionin e institucionit.

Shembull për ilustrim: Banka Credins aplikon programe motivuese si bonuse për performancë dhe njohje publike të punonjësve të dalluar ("Employee of the Month"). Gjithashtu, organizohen trajnime profesionale dhe ngjarje sociale për të forcuar frymën e ekipit.

Zgjidhja e problemeve - Aftësia për të zgjidhur probleme është jetike në institucionet financiare, për shkak të natyrës komplekse të operacioneve dhe kërkesave të klientëve. Punonjësit që dinë të analizojnë situatat, të marrin vendime të arsyetuara dhe të menaxhojnë rreziqet kontribuojnë në funksionimin më të qetë dhe efikas të institucionit. Për më tepër, kjo rrit aftësinë për t'u përshtatur me ndryshimet e vazhdueshme të tregut financiar.

Shembull për ilustrim: Në BKT (Banka Kombëtare Tregtare), gjatë pandemisë COVID-19, departamenti i kredive u përball me shumë kërkesa për shtyrje pagesash. Burimet njerëzore dhe menaxhimi bashkëpunuan për të trajnuar shpejt punonjësit në protokollat e reja të ristrukturimit të kredive, duke zgjidhur në mënyrë efikase problemet e klientëve dhe shmangur kriza të mundshme financiare.

9.3 Aftësitë e nevojshme për menaxhimin e burimeve njerëzore

Menaxhimi i burimeve njerëzore kërkon një gamë të gjerë aftësish për të qenë i suksesshëm siç paraqiten më poshtë:

- **Aftësi komunikimi:** Mënyra se si njerëzit shprehin mendimet, ndjenjat dhe informacionin në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme. Ato ndihmojnë në ndërtimin e marrëdhënieve efektive në bashkëpunimin me të tjerët.
- **Aftësitë ndërpersonale:** Aftësi të forta ndërpersonale për të ndërtuar marrëdhënie me punonjësit, për të zgjidhur konfliktet dhe për të promovuar një mjedis pozitiv pune.
- **Aftësi për zgjidhjen e problemeve:** Aftësia për të analizuar situata të vështira dhe për të gjetur zgjidhje efektive. Ato ndihmojnë në marrjen e vendimeve të zgjuara dhe përmirësimin e rezultateve në çdo aspekt të punës.
- **Aftësitë analitike:** Aftësi për të analizuar të dhënat dhe të marrë vendime të bazuara në të dhëna në lidhje me tendencat e rekrutimit, angazhimit të punonjësve dhe menaxhimin e performancës.
- **Mendimi strategjik:** Për t'u bërë një profesionist i burimeve njerëzore, nevojitet një mentalitet strategjik për t'u lidhur me qëllimet dhe objektivat e organizatës.
- **Përshtatshmëria:** Profesionistët e burimeve njerëzore duhet të përshtaten me nevojat dhe prioritetet e industrisë në ndryshim.

- **Aftësitë e teknologjisë:** Profesionistët e burimeve njerëzore duhet të jenë të aftë në përdorimin e teknologjisë dhe softuerit të burimeve njerëzore, duke përfshirë informacionin e burimeve njerëzore dhe sistemet e gjurmimit të aplikantëve.

9.4 Përfitimet e punës në ekip dhe bashkëpunimit në vendin e punës

“Gjërat e mëdha në biznes nuk bëhen kurrë nga një person i vetëm; ato bëhen nga një ekip njerëzish”

Steve Jobs

Suksesi i një biznesi shpesh bazohet në bashkëpunimin efektiv. Një grup individësh të motivuar dhe që punojnë për një qëllim të përbashkët mund të arrijnë shumë më tepër sesa një person i vetëm. Puna efektive në ekip kërkon ndarjen e njohurive dhe komunikim të mirë, gjë që përmirëson produktivitetin, çon në marrjen e vendimeve më të mira dhe nxit marrëdhënie të shëndetshme mes punonjësve.

Puna në ekip dhe bashkëpunimi janë të rëndësishme për suksesin e çdo organizate. Një mjedis bashkëpunues sjell përfitime të shumta për kompaninë dhe punonjësit.

Rrit inovacionin dhe krijimtarinë. Perspektivat e ndryshme të anëtarëve të ekipit nxisin ide të reja dhe mënyra të reja zgjidhjeje.

Siguron zgjidhje më efikase. Bashkimi i njohurive dhe aftësive ndihmon në zgjidhjen më të shpejtë dhe më të mirë të problemeve.

Përmirëson moralin dhe kënaqësinë e punonjësve. Bashkëpunimi nxit besimin, respektin dhe ndjenjën e vlerësimit në punë.

Zhvillon aftësitë e punonjësve. Punonjësit mësojnë nga njëri-tjetri dhe përmirësojnë aftësitë e buta si komunikimi dhe bashkëpunimi.

Ul rreziqet. Ndërveprimi dhe feedback-u ndihmojnë në shmangien e gabimeve dhe paragjykitimeve individuale.

Tema 10: Parandalimi i pastrimit të parave

10.1 AML-ja dhe rëndësia e saj

AML është shkurtim për "Anti-Money Laundering", që në shqip do të thotë "Mbrojtja kundër pastrimit të parave". AML është një grup ligjesh, rregullash dhe procedurash që synojnë të parandalojnë që paratë e fituara në mënyrë të paligjshme (p.sh. nga trafikimi i drogës, korrupsioni, apo krimi i organizuar) të futen në sistemin financiar dhe të përdoren si të ligjshme.

Qëllimi kryesor i saj është ruajtja e integritetit të sistemit bankar dhe financiar, si dhe parandalimi i përdorimit të bankave për qëllime kriminale.

Pastrimi i parave është procesi nëpërmjet të cilit paratë e përfituara nga aktivitetet kriminale si trafiku, korrupsioni, kontrabanda apo evazioni fiskal, maskohen dhe futen në ekonomi si të ligjshme. Në mungesë të mekanizmave të fortë kontrolli, këto para mund të dëmtojnë seriozisht ekonominë, të rrisin kriminalitetin dhe të prishin konkurrencën e ndershme në treg.

Zbatimi i masave AML është një detyrim ligjor për të gjitha bankat dhe institucionet financiare në Shqipëri. Banka e Shqipërisë, së bashku me Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPP), mbikëqyrin respektimin e ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i cili ndër vite ka pësuar përmirësime të vazhdueshme.

Sipas këtij ligji, çdo subjekt financiar duhet:

- ✓ të identifikojë dhe verifikojë klientët para hapjes së llogarive ose dhënies së kredive;
- ✓ të raportojë çdo transaksion të dyshimtë;
- ✓ të mbajë evidencë të dokumentacionit për një periudhë të caktuar ligjore;
- ✓ të trajnojë punonjësit për njohjen e shenjave të pastrimit të parave.

Rëndësia e AML-së qëndron në faktin se ajo:

- ✓ mbron reputacionin e sistemit bankar;
- ✓ forcon besimin e qytetarëve dhe investitorëve;
- ✓ parandalon përfshirjen e ekonomisë në aktivitet kriminal;
- ✓ siguron transparencë në qarkullimin e parave.

Në këtë mënyrë, AML-ja nuk është vetëm një detyrim ligjor, por edhe një mekanizëm i domosdoshëm për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe ruajtjen e sigurisë kombëtare financiare.

10.2 Procedurat dhe politikat bazë të AML-së

Procedurat dhe politikat kundër pastrimit të parave (AML–Anti-Money Laundering) janë udhëzime të brendshme që çdo institucion financiar duhet të ndjekë për të parandaluar përdorimin e sistemit bankar për qëllime të paligjshme. Ato përfshijnë kontrolle, monitorim dhe raportim të veprimtarive të dyshimta, në përputhje me ligjet kombëtare dhe standardet ndërkombëtare. Këto politika janë të domosdoshme për:

- mbrojtjen e integritetit të sistemit financiar;
- parandalimin e financimit të terrorizmit;
- rritjen e besueshmërisë së institucioneve financiare në sytë e publikut dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Politikat kryesore të AML-së:

1. Politika “Njih klientin tënd” (KYC–Know Your Customer). KYC është hapi themelor për parandalimin e pastrimit të parave. Banka duhet të dijë:

- ✓ kush është klienti (verifikimi i identitetit përmes dokumenteve zyrtare);
- ✓ cili është qëllimi i marrëdhënies bankare (p.sh., kursim, kredi, pagesa ndërkombëtare);
- ✓ burimi i fondeve (nga paga, biznesi, trashëgimia etj.);
- ✓ profili i riskut të klientit, që përcakton nivelin e monitorimit që duhet bërë më pas.

2. Monitorimi i transaksioneve. Banka përdor sisteme teknologjike që sinjalizojnë çdo aktivitet që devijon nga profili i zakonshëm i klientit. Transaksionet që mund të konsiderohen të dyshimta përfshijnë:

- ✓ depozita të përsëritura në shuma të vogla që shmangin raportimin ligjor;
- ✓ transferime ndërkombëtare të parregullta;
- ✓ transaksione që nuk kanë qëllim të qartë ekonomik.

3. Raportimi i aktiviteteve të dyshimta. Kur identifikohet një rast i dyshimtë, punonjësi i bankës ka detyrimin ligjor ta raportojë menjëherë te Oficeri i Raportimit për Pastrimin e Parave i cili më pas vlerëson dhe dërgon raportin te Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPP). Raportimi është konfidencial dhe mbrohet ligjërisht.

4. Trajnimi i stafit. Të gjithë punonjësit e institucioneve financiare trajnohen rregullisht për:

- ✓ identifikimin e klientëve me risk të lartë;
- ✓ njohjen e sinjaleve paralajmëruese (red flags);
- ✓ ndjekjen e procedurave të raportimit.

5. Ruajtja e dokumentacionit dhe gjurmueshmëria. Bankat kanë detyrimin të ruajnë të dhënat e klientëve dhe dokumentet për çdo transaksion të paktën 5 vite pas përfundimit të marrëdhënies financiare. Kjo ndihmon që autoritetet të gjurmojnë burimin e fondeve në çdo kohë.

10.3 Identifikimi i transaksioneve të dyshimta

Transaksionet e dyshimta janë ato që tregojnë shenja të mundshme të pastrimit të parave ose aktiviteteve të tjera të paligjshme. Një nga detyrat kryesore të bankave është të njohin dhe analizojnë këto situata për të parandaluar depërtimin e fondeve të jashtëligjshme në sistemin financiar. Tipologjitë më të zakonshme të transaksioneve të dyshimta përfshijnë:

- depozita ose tërheqje të shumta në shumë llogari të ndryshme në një periudhë të shkurtër;
- transaksione me vlerë të madhe, pa dokumentacion ose pa arsyetim të qartë;
- pagesa ose transferime në vende me reputacion të dobët për pastrimin e parave;
- transaksione që nuk përputhen me profilin financiar të klientit, si shuma shumë më të larta se të ardhurat e deklaruar.

Indikatorë të riskut:

Ka disa tregues që ndihmojnë bankën ose institucionin financiar të kuptojë nëse një transaksion mund të jetë i dyshimtë, si p.sh.:

- ✓ klientët refuzojnë të japin informacion të detajuar ose dokumentacion për burimin e parave;
- ✓ transaksione jashtë orarit normal të punës ose në ditë të pazakonta;
- ✓ aktivitet i papritur në llogari që zakonisht ka volumen e ulët të transaksioneve;
- ✓ transaksione që përfshijnë vende me reputacion të dobët për pastrim parash.

Roli i analizës së riskut:

Analiza e riskut është procesi ku banka vlerëson probabilitetin që një transaksion të jetë i lidhur me pastrimin e parave. Kjo përfshin:

- ✓ vlerësimin e profilit të klientit dhe historisë së tij financiare;
- ✓ identifikimin e transaksioneve me rrezik të lartë për t'u vlerësuar më tej;
- ✓ vendimmarrjen për veprime të mëtejshme, si kërkimi i informacionit shtesë ose raportimi te autoritetet.

10.4 Rast studimor: Analizimi i transaksioneve për identifikimin e situatave të dyshimta

Banka “CFC” merr sinjal nga sistemi për një llogari private me sjellje të pazakontë. Klienti A. K, 42 vjeç, pronar i një dyqani mobiljesh, ka pasuri dhe llogari personale në bankë prej 3 vitesh. Gjatë muajit të fundit, janë shënuar disa transaksione që ngjallin dyshime.

Detaji i rastit, kronologji dhe transaksione:

1. 13 Shtator: Depozitë cash 25'000 EUR (pa dokumentacion shtesë). Klienti deklaron “fitime sezonale nga tregtia”.
2. 18 Shtator: Transferim 10'000 EUR në llogari të një kompanie të re “Sh.p.k.”, e regjistruar 2 muaj më parë.
3. 20 Shtator: Tërheqje cash 8000 EUR nën arsyetimin “blerje materiale”.
4. 25 Shtator: Pesë depozita të vogla brenda një dite: $4 \times 4'900$ EUR në llogari të ndryshme të emrit të tij, hapur në filialë të ndryshëm.
5. 28 Shtator: Transferim 20'000 EUR jashtë vendit, në një vend me rrezik të konsiderueshëm për AML.

6. 30 Shtator: Klienti refuzon të japë kopje të faturave ose kontratave që të justifikojnë depozitimin prej 25'000 EUR, depozituar më 13 Shtator.

Informacion shtesë mbi klientin:

- ✓ Profesionit: pronar dyqani mobiljesh, depozita dhe llogari prej 3 vitesh.
- ✓ Të ardhurat e deklaruar janë të ulëta krahasuar me vëllimin e transaksioneve të fundit.
- ✓ Kompania “Sh.p.k.” ka adresë të ndryshme nga ajo që deklaroi klienti dhe nuk ka kontrata publike që justifikojnë shumën.

10.5 Bashkëpunimi me strukturat e tjera

Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar është thelbësor për parandalimin e pastrimit të parave, sepse aktivitetet kriminale shpesh kalojnë kufijtë kombëtarë. Bankat dhe institucionet financiare nuk mund të veprojnë vetëm, ata bashkëpunojnë ngushtë me agjencitë ligjzbatuese, autoritetet tatimore, doganat dhe strukturat ndërkombëtare. Ky koordinim siguron shkëmbim efikas të informacionit, ndihmon në identifikimin e transaksioneve të dyshimta dhe përshpejton hetimet mbi aktivitetet kriminale. **Elementët kryesorë të bashkëpunimit:**

- Agjencitë ligjzbatuese: Policia, Prokuroria, Doganat dhe Autoritetet Tatimore, janë përgjegjëse për monitorimin, hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të pastrimit të parave dhe krimit financiar.
- Institucionet financiare: Bankat dhe institucionet e tjera financiare kanë rolin kryesor në identifikimin, raportimin e transaksioneve të dyshimta dhe bashkëpunimin me organet kompetente.
- Bashkëpunimi ndërkombëtar: Organizata si FATF (Financial Action Task/Grupi i Veprimit Financiar), Interpol dhe rrjete të tjera ndërkombëtare, ndihmojnë në harmonizimin e politikave, shkëmbimin e informacionit dhe hetimin e transaksioneve ndërkufitare.

Pse është i rëndësishëm bashkëpunimi?

- ✓ forcon sistemin financiar dhe legjislativ të vendit;
- ✓ ndihmon në zbulimin dhe ndalimin e aktivitetit kriminal;
- ✓ mbron ekonominë dhe reputacionin e institucioneve financiare;
- ✓ siguron që paratë e pista të mos hyjnë në qarkullim të ligjshëm.

10.6 Rast studimor: Një nga gabimet më të mëdha në luftën kundër pastrimit të parave

Gjatë dekadës së fundit, pajtueshmëria me rregullat kundër pastrimit të parave (AML) është përballur me sfida të mëdha, me një sërë dështimesh të bujshme që kanë rezultuar në gjopa rekord. Pavarësisht rritjes së rregulloreve dhe përdorimit të mjeteve më të avancuara, institucionet e mëdha financiare vazhdojnë të bëjnë gabime të kushtueshme, duke theksuar rëndësinë e praktikave të forta të AML-së.

Një prej dështimeve më të mëdha në fushën e AML-së gjatë viteve të fundit dhe mënyra se si ky rast mori vëmendje të madhe mediatike shërbeu si një kujtesë e qartë për rëndësinë jetike të praktikave të forta kundër pastrimit të parave.

Gjobë prej £264 milionësh për NatWest për mosreagim ndaj sinjaleve paralajmëruese (2021)

NatWest është një nga bankat më të mëdha tregtare britanike me shtrirje të gjerë në Mbretërinë e Bashkuar dhe ka histori mbi 200 vjeçare në sektorin bankar. Ajo u shërben klientëve të ndryshëm

biznesi dhe individëve. Në dhjetor 2021, NatWest u bë pjesë e titujve kryesorë të mediave pasi iu vendos një gjobë prej £ 264.8 milionësh për shkelje të rënda të rregullave kundër pastrimit të parave (AML). Rasti përfshinte depozita cash prej £365 milionësh gjatë një periudhe pesëvjeçare nga një klient i vetëm, ndërkohë që banka nuk reagoi ndaj sinjaleve të përsëritura paralajmëruese. Klienti ishte një biznes i vogël me bazë në Bradford, i cili midis viteve 2011 dhe 2016, depozitoi shuma të mëdha parash në llogaritë e veta, që dukshëm nuk përputheshin me përmasën dhe aktivitetin e biznesit. Depozitat arritën deri në £1.8 milion në disa ditë, gjë që duhej të kishte shkaktuar një kontroll të menjëhershëm. Megjithatë, NatWest nuk ndërmori hetime të plota, duke lejuar që aktiviteti i dyshimt të vazhdonte.

Sinjalet paralajmëruese (red flags):

- ✓ Kur sjellja financiare e një klienti nuk përputhet me pritshmëritë, në vëllim, shpeshtësi apo origjinën e fondeve, ekipet e pajtueshmërisë duhet të reagojnë menjëherë.
- ✓ Programet e AML-së duhet të jenë të orientuara nga rreziku, duke përqendruar burimet te klientët dhe transaksionet me risk të lartë.
- ✓ Në rastin e NatWest, mungesa e analizës dhe e pyetjeve të duhura mbi depozitat e mëdha në para të gatshme çoi në një shkelje të rëndë.
- ✓ Ekipet e pajtueshmërisë duhet të monitorojnë vazhdimisht llogaritë me risk të lartë dhe të hetojnë menjëherë çdo sinjal paralajmërues.

Tema 11: Siguria fizike dhe operacionale

11.1 Privatësia dhe Mbrojtja e të Dhënave Personale në sistemin bankar

Në sektorin bankar, ruajtja e konfidencialitetit të informacionit të klientit është një nga detyrimet më të rëndësishme ligjore dhe etike. Çdo institucion financiar duhet të garantojë se të dhënat personale përpunohen vetëm për qëllime të ligjshme, me transparencë dhe siguri maksimale. Shkelja e privatësisë mund të çojë jo vetëm në humbje të besimit të klientëve, por edhe në pasoja ligjore të rënda për bankën.

Kuptimi i të dhënave personale dhe privatësisë

- **Të dhënat personale** përfshijnë çdo informacion që lidhet me një individ të identifikueshëm, si: emri, numri i identifikimit personal, adresa, numri i llogarisë, të ardhurat, apo historiku i transaksioneve.
- **Privatësia** nënkupton të drejtën e individit që këto të dhëna të mos zbulohen ose përdoren pa pëlqimin e tij.

Në Shqipëri, mbrojtja e të dhënave personale rregullohet nga Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe nga rregulloret e Autoritetit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (AMDP). AMDP është institucioni mbikëqyrës që siguron zbatimin e ligjit, trajton ankesat e qytetarëve dhe mund të vendosë masa administrative ndaj institucioneve që shkelin rregullat e mbrojtjes së të dhënave. Bankat dhe të gjitha institucionet financiare janë të detyruara të përpunojnë të dhënat e klientëve në përputhje me parimet e nevojshmërisë, proporcionalitetit dhe sigurisë. Parimet bazë të mbrojtjes së të dhënave:

- ✓ **Ligjshmëria dhe transparencia**, të dhënat përpunohen vetëm për qëllime të qarta dhe ligjore, të komunikuar klientit.
- ✓ **Kufizimi i qëllimit**, të dhënat përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë mbledhur (p.sh., hapja e llogarisë, miratimi i kredisë).
- ✓ **Minimizimi i të dhënave**, grumbullohen vetëm të dhënat që janë të domosdoshme.

- ✓ **Saktësia**, Institucioni duhet të sigurojë që informacioni i klientit të jetë gjithmonë i përditësuar.
- ✓ **Siguria**, përdoren masa teknike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat nga qasja e paautorizuar, humbja ose dëmtimi.
- ✓ **Kufizimi i ruajtjes**, të dhënat ruhen vetëm për periudhën e nevojshme, sipas ligjit.

Masat praktike për ruajtjen e privatësisë në banka:

- ✓ përdorimi i kodeve të sigurisë, fjalëkalimeve dhe autentifikimit me shumë faktorë;
- ✓ trajnimi periodik i punonjësve mbi rregullat e konfidencialitetit;
- ✓ nënshkrimi i marrëveshjeve të konfidencialitetit për të gjithë punonjësit që kanë akses në të dhënat e klientëve;
- ✓ monitorimi i hyrjeve në sistemet elektronike për të shmangur abuzimet;
- ✓ informimi i klientëve për mënyrën si përpunohen të dhënat e tyre dhe të drejtat që ata kanë për akses, korrigjim apo fshirje të informacionit.

11.3. Zbatimi i procedurave të shërbimeve bankare dhe ruajtja e kredencialeve

Në çdo operacion bankar, ndjekja e protokolleve zyrtare është thelbësore për të siguruar saktësinë e transaksioneve dhe mbrojtjen e interesave të klientëve. Punonjësit e bankave nuk mund të veprojnë sipas mendimit personal, çdo veprim kryhet sipas rregullave të përcaktuara, përmes dokumenteve, formularëve dhe verifikimeve të brendshme. Kjo siguron:

- ✓ shërbim profesional dhe të standardizuar;
- ✓ minimizim të gabimeve;
- ✓ mbrojtje nga mashtrimet dhe keqpërdorimet;
- ✓ gjurmim të çdo veprimi përmes sistemit elektronik të bankës.

Në çdo bankë, çdo veprim regjistrohet dhe mund të kontrollohet në çdo moment, duke garantuar transparencë dhe përgjegjësi. Dokumentacioni zyrtar është prova ligjore e çdo veprimi financiar. Çdo transaksion, hapje llogarie, kredi apo pagesë duhet të mbështetet me dokumente të sakta dhe të nënshkruara nga personat përgjegjës. Ruajtja e saktë e dokumentacionit ndihmon në:

- ✓ parandalimin e gabimeve financiare;
- ✓ mbrojtjen ligjore të bankës dhe klientit;
- ✓ kontrollin dhe verifikimin e brendshëm.

Ruajtja e kredencialeve

Kredencialet janë të dhënat që i japin një punonjësi të drejtën e hyrjes në sistemet bankare (fjalëkalime, kode, çelësa elektronikë, karta identifikimi). Ruajtja e tyre është thelbësore për sigurinë operacionale të institucionit financiar. Nuk lejohet ndarja e fjalëkalimeve mes punonjësve, shkrimi i kodeve në letra të lëna mbi tavolinë apo në vende që mund të shihen lehtësisht nga persona të tjerë, ruajtja e kredencialeve në kompjuter pa enkriptim, si dhe hyrja në aplikacionet e bankës nga pajisje që nuk janë të autorizuar nga institucioni. Çdo hyrje në sistem lidhet me një përdorues të caktuar dhe nëse ndodh ndonjë abuzim apo veprim i parregullt, përgjegjësia identifikohet menjëherë përmes log-ut të sistemit, i cili ruan të gjitha veprimet e kryera. Çdo përdorim i paautorizuar i kredencialeve mund të sjellë humbje financiare, shkelje të privatësisë dhe përgjegjësi ligjore për punonjësin dhe institucionin.

Masat kryesore që ndihmojnë në ruajtjen e kredencialeve dhe zbatimin e procedurave:

1. **Identifikimi dhe autentikimi i përdoruesve:** Çdo punonjës duhet të përdorë fjalëkalime personale dhe autentikim të dyfishtë kur është e mundur.

2. **Ruajtja fizike e dokumentacionit:** Dokumentet me informacion financiar duhet të ruhen në arkiva të sigurta, të mbyllura dhe të kontrolluara me qasje të kufizuar vetëm për personat e autorizuar.
3. **Monitorimi i qasjes (aksesit) në sistemet bankare:** Sistemet elektronike regjistrojnë çdo hyrje dhe veprim, duke mundësuar gjurmimin në rast të dyshimeve për keqpërdorim.
4. **Edukimi dhe trajnimi i stafit:** Punonjësit trajnohen për të njohur rreziqet, për të respektuar procedurat e sigurisë dhe për të reaguar ndaj situatave të dyshimta.

11.4. Sigurimi teknik dhe identifikimi i vlerave

Në çdo institucion financiar, identifikimi dhe mbrojtja e vlerave përbën një element themelor të sigurisë operationale. Vlerat nuk përfshijnë vetëm paratë fizike, por edhe dokumentet financiare, çeqet, obligacionet, kartat bankare dhe të dhënat elektronike që përfaqësojnë pasuri monetare.

✓ Identifikimi i vlerave

Identifikimi i saktë i vlerave ndihmon bankën të përcaktojë nivelin e mbrojtjes që duhet të aplikohet për secilin lloj aktiviteti. Për shembull, një kasafortë që ruan para fizike kërkon masa më të rrepta sigurie sesa një arkiv që përmban dokumente të zakonshme.

Procesi i identifikimit përfshin vlerësimin e rreziqut, kategorizimin e pasurive sipas rëndësisë dhe përcaktimin e mënyrës së ruajtjes apo monitorimit të tyre. Kjo u mundëson institucioneve financiare të parandalojnë humbjet, mashtrimet apo dëmet që mund të shkaktohen nga gabime njerëzore ose nga ngjarje të jashtme.

✓ Sigurimi teknik

Pas identifikimit të vlerave, hapi tjetër është sigurimi teknik, i cili lidhet me zbatimin e mjeteve, pajisjeve dhe sistemeve elektronike që garantojnë mbrojtjen e tyre fizike. Në çdo degë të bankave përdoren kamera sigurie për monitorim të vazhdueshëm, sisteme alarmi që sinjalizojnë çdo tentativë hyrjeje të paautorizuar, kasaforta të blinduara për ruajtjen e parave dhe sisteme të kontrollit të hyrjeve, që lejojnë vetëm personel të autorizuar të futet në ambiente të caktuara.

Shumë institucione financiare përdorin gjithashtu sisteme biometrike, si leximi i shenjave të gishtërinjve apo i fytyrës, për të rritur nivelin e sigurisë në hapësirat me vlera të larta. Pajisjet e sigurimit teknik janë të lidhura me qendrat e monitorimit dhe regjistrojnë çdo veprim apo alarm në mënyrë automatike, duke lejuar gjurmimin e ngjarjeve në kohë reale.

Sigurimi teknik dhe identifikimi i vlerave janë dy procese që plotësojnë njëra-tjetrën: i pari garanton njohjen dhe kategorizimin e pasurive, ndërsa i dyti siguron mbrojtjen efektive të tyre, përmes teknologjisë dhe kontrolleve të rrepta fizike. Kjo lidhje e drejtpërdrejtë siguron që çdo vlerë, qoftë monetare, dokumentare apo elektronike, të jetë e mbrojtur ndaj rreziqeve të brendshme dhe të jashtme, duke ruajtur besueshmërinë dhe stabilitetin e institucionit financiar.

11.5. Manualët, mjetet dhe pajisjet e sigurisë teknike

Në punën e përditshme të një banke, siguria nuk është thjesht një detyrë, por një pjesë e pandashme e funksionimit të saj. Për këtë arsye, çdo institucion financiar ka krijuar manuale dhe udhëzime të brendshme që shërbejnë si udhërrëfyes për punonjësit. Këto manuale përshkruajnë qartë mënyrat se si duhet të veprohet në situata të zakonshme, si dhe reagimin ndaj emergjencave, duke përfshirë tentativat e vjedhjes, sulmet kibernetike apo incidentet e tjera të sigurisë. Manualët nuk shërbejnë vetëm për të udhëzuar punonjësit, por gjithashtu për të standardizuar proceset, duke siguruar që çdo veprim të kryhet në mënyrë të sigurt dhe të kontrolluar. Ato mund të përfshijnë:

- ✓ udhëzime për verifikimin e dokumentacionit të klientëve;
- ✓ mënyrat e reagimit në rast alarmi;
- ✓ procedurat për ruajtjen dhe qasjen në dokumente financiare dhe të dhëna elektronike.

Përveç manualeve, bankat përdorin një gamë të gjerë mjetesh dhe pajisjesh teknike për të garantuar mbrojtjen e vlerave. Kamera CCTV dhe sistemet e monitorimit mundësojnë vëzhgimin e vazhdueshëm të ambienteve të brendshme dhe të jashtme të degëve të bankave. Sistemet e alarmit sinjalizojnë menjëherë çdo tentativë hyrjeje të paautorizuar, ndërsa kontrollet e qasjes fizike, si dyer të blinduara, kartela identifikimi apo sisteme biometrike, lejojnë që vetëm personeli i autorizuar të hyjë në hapësira të caktuara. Një element i rëndësishëm është mirëmbajtja e pajisjeve dhe përmirësimi i vazhdueshëm i sistemeve të sigurisë. Një kamera ose sistem i dëmtuar zvogëlon ndjeshëm nivelin e sigurisë. Prandaj, institucionet financiare zhvillojnë rregullisht kontrolle dhe përditësime të sistemeve, për të garantuar që çdo mjet sigurie të jetë efektiv dhe funksional. Ky proces i vazhdueshëm e bën sigurinë të besueshme dhe ndihmon në parandalimin e incidenteve para se ato të ndodhin. Pajisjet dhe mjetet e sigurisë nuk funksionojnë në mënyrë të pavarur. Ato janë të lidhura me qendrat e monitorimit dhe regjistrojnë çdo veprim, duke mundësuar gjurmimin e ngjarjeve në kohë reale. Kjo siguron që çdo incident të analizohet dhe menaxhohet shpejt, duke mbrojtur klientët, punonjësit dhe reputacionin e bankës.

11.6. Përgjegjësia sociale dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Bankat sot nuk shihen vetëm si institucione financiare, por edhe si pjesë aktive e shoqërisë. Përgjegjësia sociale e bankave përfshin të gjitha veprimtaritë që synojnë përmirësimin e mjedisit, mbështetjen e komuniteteve dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm.

Në praktikë, kjo përfshin:

- ✓ **Menaxhimi i burimeve natyrore dhe kursimi i energjisë:** Bankat zbatojnë masa për reduktimin e konsumit të energjisë, përdorin pajisje me efikasitet të lartë, dhe inkurajojnë përdorimin e energjisë së rinovueshme.
- ✓ **Transaksionet elektronike dhe teknologjitë e gjelbra:** Shumë banka promovojnë transaksione elektronike për të reduktuar përdorimin e letrës, duke ulur kështu mbeturinat dhe emetimet karbonike.
- ✓ **Programet sociale dhe edukative:** Bankat ndihmojnë komunitetet, duke financuar projekte sociale, si restaurime shkollash, ndihma për familjet në nevojë ose seminare për menaxhim financiar të qëndrueshëm dhe mbështesin iniciativat lokale për zhvillim ekonomik.
- ✓ **Raportimi dhe transparenca:** Bankat raportojnë rregullisht mbi aktivitetet e përgjegjësisë sociale, duke treguar ndikimin e tyre në komunitet dhe mjedis, si dhe përputhshmërinë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të qëndrueshmërisë.

Shumë banka, në funksion të politikave të tyre mbi zhvillimin e qëndrueshëm ofrojnë gjithashtu të ashtu quajturat “*Green Loan*”, paketa financimi me kushte të favorshme për investime të gjelbra. Kështu nëse klientët aplikojnë për finacime në investime që synojnë kursimin e energjisë, përdorimin e burimeve të rinovueshme apo reduktimin e emetimeve dhe mbrojtjen e mjedisit ato mund të përfitojnë norma më të ulta interesi.